



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare e Tiranës”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMI

MBI

“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”

NË “MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE PËR PROJEKTIN “FUQIZIMI I QENDRËS TRAUMATOLOGJIKE KOMBËTARE TË TIRANËS”

TIRANË, qershor 2024

NR.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	9
II	HYRJA	11
1	Objektivat dhe qëllimi	11
2	Identifikimi i çështjes	11
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11
4	Përgjegjësitë e audituesve	12
5	Kriteret e vlerësimit	12
6	Standardet e auditimit	13
7	Metodat e auditimit	13
8	Dokumentimi i auditimit	13
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	14
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	14
2.1	Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.	14
2.2	Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre.	30
2.3	Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit.	36
2.4	Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.	42
2.5	Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.	49
2.6	Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.	51
2.7	Mbi administrimin e veprave të dorëzuara, funksionimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve.	58
IV	REKOMANDIME	62
V	LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT	67

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Për realizimin e projektit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës" është lidhur marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 9617, datë 16.10.2006, për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës", në formën e kredisë ndihmëse në shumën 5,000,000 Euro dhe një donacion në shumën 150,000 Euro.

Bazuar në këtë marrëveshje është nënshkruar Marrëveshja Financiare midis Ministrisë së Financave dhe Artigiancassa Spa ratifikuar me Ligjin nr.9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa spa për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

Programi përmban dy objektiva bazë (Objektivat e Programit) të cilët janë:

1. Objektivi i përgjithshëm i Programit është i vetëm dhe qëndron në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të popullsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë të popullsisë së prekur nga trauma;
2. Objektivat specifik të cilët kërkojnë të bëjnë më eficientë e më efikasë veprimtarinë terapeutike të Qendrës Traumatologjike Kombëtare, duke rritur në këtë mënyrë ndikimin mbi shëndetin e popullsisë dhe njëkohësisht për të përmirësuar prognozën *quod validitatem* të pacientëve politraumatikë me pasojë uljen e paaftësive të përkohshme dhe të përhershme dhe të kostove që lidhen me to.

Programi synon të arrijë pajisjen e Qendrës Traumatologjike Kombëtare me aparaturat e duhura mjekësore dhe ta bëjë atë të përshtatshme për rolin që ajo ka si pikë referimi kombëtare për pacientët e traumatizuar. Nga auditimi rezultuan në mënyrë të përmbledhur:

- Vonesa të pajustificuara në implementimin e programit të cilat kanë ardhur kryesisht nga pala shqiptare pasi, nga viti 2006 deri në vitin 2014 për projektin nuk rezultoi të jetë zhvilluar asnjë aktivitet për të vënë në lëvizje strukturat kompetente të cilat do të siguronin zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja dhe arritjen në kohë të objektivave të projektit.

- Implementimi real i tij ka filluar në vitin 2014 kur janë evidentuar nevojat fillestare të spitalit nga eksperti italian i Cooperazione Italiana, ndërsa realizimi i procedurave të prokurimit ka filluar në vitin 2015. Nga ky moment deri në përfundim të projektit kanë kaluar 5 vjet dhe rezultati i arritur nga projekti është i ndarë në përpjesëtim të jo të drejtë në vite, pasi edhe gjatë fazës së zbatimit të kontratave me operatorët ekonomik fitues, projekti nuk ka vazhduar për shkak të rikonstruksionit të Spitalit Universitar të Traumës. Fakt i cili ka ndikuar në një tjetër vonesë për realizimin sa më të shpejt të tij.

- Nuk ka një ndarje të qartë në lidhje me shumën që janë akorduar për secilin nga komponentët e projektit, nuk është hartuar raporti përfundimtar i vlerësimit të projektit dhe nuk mund të evidentohet ndarja e këtyre zërave sipas kontratave të lidhura, pasi në një prej kontratave të lidhura mund të jepen përfshirë pajisje që u shërbejnë 2 ose më shumë loteve të cilat në vetvete përfshinë pajisje që mund t'i përkasin komponentëve të ndryshëm. Edhe pse implementimi dhe marrja në dorëzim e pajisjeve ka përfunduar nuk mund të shprehemi mbi arritjen e objektivit specifik të projektit.

- Nuk ka dokumentimin të të gjitha fazave të implementimit të projektit, në ruajtjen e dokumentacionit, si dhe në ndjekjen dhe monitorimin e projektit nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për menaxhimin e tij, në përputhje me përcaktimin e sanksionuar në Marrëveshjen bazë.

- Objektivi i projektit, pra pajisja me aparatura mjekësore duke e bërë atë të përshtatshme si pikë referimi për pacientët e traumatizuar është realizuar edhe pse jo në kohë (*me mbi 16 vjet vonesë nga marrëveshja fillestare*). Mbi realizimin e objektivave specifik grupi i auditimit

refuzon të japi opinion pasi nuk është hartuar raporti i vlerësimit përfundimtar nga spitali i traumës si përfituesi direkt i kredisë së ndihmës, në zbatim të nenit 15, pika 5 e të Ligjit nr. 9617, datë 16.10.2006, si dhe nuk kemi indikatorë të matshëm mbi ndikimin në shëndetin e pacientëve politraumatikë të cilët jenë trajtuar mbas zbatimit të projektit, në mënyrë që të mund ti krahasonim ato.

- Nuk është ngritur komiteti drejtues, për pasojë asnjë nga detyrat të cilat citohen në nenin 6 të marrëveshjes së programit nuk rezulton të jetë kryer konkretisht nuk është kryer monitorimi dhe vlerësimi i programit në të gjitha fazat e tij. Nuk është kryer analiza përfundimtare e kontrollit të veprimtarive të programit. Si rrjedhojë sistemi i monitorimit të programit nuk ka funksionuar.

- Për shumat e përfituara nga kontraktorët e huaj nuk është vlerësuar/marrë në konsideratë mbajtja tatimit mbi të ardhurat në vlerën 749,475.054 euro (4,996,500.36 x 15 %) vlerë e cila përfshin pagesat e kryera për kontraktorët. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale dhe kontraktorët/kompanitë Italiane nuk kanë aplikuar dhe dorëzuar në organet tatimore formularët për eliminimin e tatimit të dyfishtë.

Ministria nuk i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për interpretim lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për të dhënë argument shterues për mbajtjen ose jo të tatimit mbi të ardhurat, për të shmangur keq interpretimet e zbatimit të dispozitave të poshtë shënuara në lidhje me këtë çështje.

- Nga pajisjet mjekësore të furnizuara për periudhën 2019-2020 u inspektuan 17 të tilla me vlerë 210,952 euro. Për këto pajisje mjekësore të instaluar nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM)/kartela e shërbimit për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj).

Objekt i këtij auditimi është dhënia e opinionit nëse është kryer përdorimi i përshtatshëm i fondeve, procese specifike të aktivitetit dhe operacioneve të subjektit të auditimit të sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim.

Janë audituar 4 transaksionet e kryera për mbylljen e projektit, si dhe procedurat doganore për pajisjet, në total është audituar vlera prej **942,884 euro, nga e cila 39,945.26 euro janë pajisje të ardhura pas datës 31.12.2018, pjesa tjetër janë pajisje mjekësore (mjete konsumi dhe orendi) të ardhura përpara kësaj date por pagesa është kryer në vitin 2019-2020.** U audituan në terren pajisjet mjekësore në vlerën 210,952 euro.

Disa nga gjetjet dhe rekomandimet kryesore:

1.Gjetje nga auditimi: Për realizimin e projektit “*Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës*” Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes nuk kanë zbatuar përcaktimet e marrëveshjeve për fuqizimin e Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës, lidhur me institucionin kompetent për zhvillimin e procedurave të prokurimit, si dhe ato lidhur me përqindjen e kredisë së ndihmës që do të përdorej për kosto lokale dhe/ose në vendet në zhvillim, por kanë zbatuar ndryshimet e marrëveshjes qeveritare, ende pa hyrë në fuqi këto ndryshime.

Procedurat e prokurimit (1 procedurë me 7 lote), janë zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë, e cila bazuar në ligjet në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave, nuk e kishte një kompetencë të tillë, si dhe në dokumentet që përcaktojnë kriteret dhe procedurën e prokurimit është

përcaktuar një përqindje më e lartë e kredisë së ndihmës për kosto lokale dhe/ose në vendet e OECD-së, duke zbatuar, pa hyrë ende në fuqi, parashikimet e ndryshimeve të marrëveshjes qeveritare, të cilat janë ratifikuan nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 21.12.2015 dhe janë botuar në fletoren zyrtare nr. 246, datë 21.01.2016, ndërkohë që njoftimi për fillimin e procedurave të prokurimit është bërë në datën 29.07.2015 dhe shpallja e fituesve të këtyre procedurave është bërë më 26.11.2015 në kundërshtim me në nenet: 4 pika b, paragrafi i parë; 5, pika c, paragrafi 4,5; 6; 14; Aneksi 3, Seksioni I pika 1,3; Aneksi 3, Seksioni II pika 1,2,4 të Ligjit nr. 9617, datë 16.10.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me objekt realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për të korrigjuar këtë praktikë në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe në lidhje me ndryshimet e tyre, të bëhet konfirmim nga sektori përkatës i këshillimit ligjor lidhur me momentin e hyrjes në fuqi të dispozitave përkatëse që ju kalojnë ose ju heqin strukturave të tyre kompetencat juridike lidhur me zbatimin e projekteve, me qëllim shmangien e këtyre praktikave në të ardhmen.

2.Gjetje nga auditimi: Në implementimin e projektit ka pasur vonesa të pajustificuara të cilat kanë ardhur kryesisht nga pala shqiptare, pasi rezulton se nga fillimi i tij deri në vitin 2014, për projektin nuk rezulton të jetë zhvilluar asnjë aktivitet për të vënë në lëvizje strukturat kompetente të cilat do të siguronin zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja. Ky projekt për një periudhë të gjatë nuk ka funksionuar duke rezultuar në gjendje jo aktive. Edhe pse një vonesë e tillë nuk ka pasur efekt financiar, ka ndikuar në mos arritjen në kohë të objektivit kryesor të tij, i cili është një i vetëm dhe qëndron në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të popullsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë të popullsisë së prekur nga trauma, si dhe objektivave specifik.

Referuar shkresës nr. 1179/29, datë 23.11.2016, *implementimi real i projektit ka filluar në vitin 2014*, kur janë evidentuar nevojat fillestare të spitalit nga eksperti italian i Cooperazione Italiana, ndërsa realizimi i procedurave të prokurimit ka filluar në vitin 2015. Nga ky moment deri në përfundim të projektit kanë kaluar 5 vjet dhe rezultati i arritur nga projekti është i ndarë në përpjesëtim jo të drejtë në vite, pasi edhe gjatë fazës së zbatimit të kontratave me operatorët ekonomik fitues, projekti nuk ka vazhduar për shkak të rikonstruksionit të Spitalit Universitar të Traumës. Ky fakt ka ndikuar ka ndikuar në një tjetër vonesë për realizimin e tij.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Spitalin Universitar të Traumës nuk është hartuar raporti përfundimtar i implementimit të projektit, në të cilin duhet të ishin analizuar realizimi i objektivave specifik dhe të përcaktoheshin me hollësi shkaqet, arsyet dhe argumentet për vonesën e realizimit të projektit duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Njësia e Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me Spitalin Universitar të Traumës, të marrin masa për hartimin e një raporti përfundimtar të implementimit të projektit, ku të analizohet realizimi i objektivave specifik dhe të përcaktohen me hollësi shkaqet, arsyet dhe argumentet për vonesën e realizimit të projektit duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse.

3. Gjetje nga auditimi: Nuk ka një ndarje të qartë në lidhje me shumat që janë akorduar për secilin nga komponentët e projektit dhe nuk është evidentuar ndarja e zërave sipas kontratave të lidhura, pasi në një prej kontratave të lidhura mund të jene përfshirë pajisje që u shërbejnë 2 ose më shumë loteve, të cilat në vetvete përfshinë pajisje që mund t'i përkasin komponentëve të ndryshëm.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Njësia e Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me spitalin e traumës të ngrejë një grup pune i cili të ndajë sipas

komponentëve të projektit të gjitha pajisjet mjekësore në bazë të kontratave të lidhura, me qëllim evidentimin e saktë të tyre për të qartësuar përmbushjen e komponentëve dhe objektivave specifik të programit.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për zbatimin e projektit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë nuk është ngritur komiteti drejtues, për pasojë asnjë nga detyrat të cilat citohen në nenin 6 të marrëveshjes së programit nuk rezulton të jetë kryer, konkretisht: nuk është kryer monitorimi dhe vlerësimi i programit në të gjitha fazat e tij. Po ashtu nuk është kryer analiza përfundimtare e kontrollit të veprimtarive të programit. Si rrjedhojë sistemi i monitorimit të programit nuk ka funksionuar.

4.1 Rekomandime: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të administrohen nga ana e saj në të ardhmen, t'i përmbahet marrëveshjeve bazë financiare si dhe programit të financimit, duke ngritur strukturat përkatëse të monitorimit të përcaktuara në marrëveshje, me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e projektit si dhe evidentimin e problemeve në faza të ndryshme të programit, rritjen e efektivitetit të projekteve me financime të huaja.

5. Gjetje nga auditimi: Nuk ka dokumentimin të të gjitha fazave të implementimit të projektit, në ruajtjen e dokumentacionit, si dhe në ndjekjen dhe monitorimin e projektit nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për menaxhimin e tij, në përputhje me përcaktimin e sanksionuar në Marrëveshjen bazë, ku përcaktohet se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të kujdeset për koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe menaxhuese të nevojshme për realizimin e programit. Detyrat për menaxhimin e projektit nuk ka qenë e deleguar dhe e mirë përcaktuar nga ana e institucioneve shqiptare të përfshira në implementimin e tij. Ky projekt ka mangësi të theksuar si në dokumentacionin e fazave të zhvillimit ashtu edhe në mbledhjen, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve fizik dhe letrave të punës për periudhën nga fillimi i tij deri më datë 11.11.2014. Edhe gjatë fazës së implementimit të tij nga Ministria e Shëndetësisë kur janë caktuar drejtuesit e programit, nuk janë caktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të përfshirë në implementimin e projektit dhe dorëzimi i dokumentacionit nga njëri staf në tjetrin nuk është dokumentuar dhe zhvilluar sipas procedurave të kërkuara nga aktet ligjore në fuqi.

5.1 Rekomandimi: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të administrohen nga ana e saj në të ardhmen, të përcaktojë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të përfshirë në implementimin e projekteve, në përputhje me marrëveshjet përkatëse, me qëllim monitorimin e projektit dhe nxjerrjen e përgjegjësive në rastet e vonesave të mundshme, si dhe dorëzimi i dokumentacionit në rastet e ndryshimit të stafit të dokumentohet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në përfundim të projekteve të merren masa për arkivimin e plotë të dokumentacionit të projektit.

6. Gjetje nga auditimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk është përcaktuar një afat për përfundimin e projektit, si dhe një grafik kohe për jetëgjatësinë dhe ecurinë në vite, nuk është hartuar një dokument i vlerësimit të projektit (PAD), veprime të cilat kanë sjellë një tejzgjatje në kohë për zbatimin të tij (projektit). Midis dy palëve Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe palës italiane, për ndalimin e projektit nuk është bërë një riaktivizim i projektit apo një program që cakton radhën e veprimeve në vazhdimësi, veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të Marrëveshjes së kredisë, ku përcaktohet se nëse zgjatja e pengesave është më e madhe se 24 muaj, palët janë të detyruara të bien dakord mbi vazhdimin e projektit dhe të caktojnë radhën e veprimeve. Nga situata dhe nga ecuria e projektit, vlerësojmë se koha e implementimit dhe rezultatet e prekshme, janë në raport jo të drejtë me njëri-tjetrin.

6.1 Rekomandimi: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të administrohen nga ana e saj në të ardhmen, t'i përmbahet marrëveshjeve bazë financiare si dhe programit të financimit si dhe të përcaktohet një afat

kohor për përfundimin e projektit, grafiku për ecurinë në vite, si dhe të hartohet dokumenti i vlerësimit të projektit. Në rastet e ndalimit të përkohshëm projektit të dakortësohet për vazhdimin e tij dhe të caktohet radha e veprimeve pas riaktivizimit të projektit.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcjell në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 1417/8 datë 09.08.2019, u konstatua se:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, për përgatitjen programe me afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për rekomandimet e lëna për projektin “*Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës*”.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka raportuar pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimn e mëparshëm, pasi në shkresën 1417/8 datë 09.08.2019, prej subjektit është përcjellë vetëm plani i masave, veprime në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga KLSH janë dhënë 12 masa organizative nga të cilat 1 masë është zbatuar dhe 11 masa nuk janë zbatuar; nga 6 masa për shpërbllim dëmi në vlerën 795,351.86 euro pa TVSH rezulton se nuk është zbatuar asnjë masë. Është rekomanduar 1 masë disiplinore e cila rezulton e pazbatuar.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat nga ky auditim rezultuan të pazbatuara dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi.

8. Gjetje nga auditimi: Kontratat e lidhura në kuadër të marrëveshjes në interpretim të Konventës së Vjenës të muajit maj 2009, Ligjit nr. 10 092, datë 09.03.2009 “*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave*”, si dhe doktrinës dhe jurisprudencës ndërkombëtare për shitjen e mallrave, kanë lënë shteg për keqinterpretime në zbatimin e tyre dhe në veçanti për eliminimin e tatimit të dyfishtë.

Për realizimin e plotë të projektit, në zbatim të kontratave respektive kontraktorët/kompanitë Italiane kanë përfituar në total vlerën 4,996,500.36 euro. Për këtë vlerë nuk është vlerësuar/marrë në konsideratë mbajtja tatimit mbi të ardhurat në vlerën 749,475.054 euro (4,996,500.36 x 15 %).

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale dhe kontraktorët/kompanitë Italiane nuk kanë aplikuar dhe dorëzuar në organet tatimore formularët për eliminimin e tatimit të dyfishtë në zbatim të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “*Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal*”.

Rekomandimi 8.1: Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, t’i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për interpretim lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, date 10.02. 2004 “*Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal*”, për të dhënë argument shterues lidhur me mbajtjen ose jo të tatimit mbi të ardhurat, për të shmangur keq interpretimet e zbatimit të dispozitave të sipërcituara në lidhje me këtë çështje.

Rekomandimi 8.2: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në vlerësimin dhe mbajtjen e tatimit mbi të ardhurat, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

9. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektimi i 17 pajisjeve mjekësore të furnizuara dhe instaluar në SUT me vlerë 210,952 euro për periudhën 2019-2020 u konstatua se megjithëse pajisjet janë

në gjendje pune nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve.

- Nga SUT nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM)/kartela për shërbimet e kryera për pajisjet si dhe dokumentimin e historikut të saj (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj.).

Sa më sipër në plotësim të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet.

Rekomandimi 9.1: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Spitali Universitar i Traumës të marrin masa në planifikimin në buxhet të fondeve për sigurimin e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore duke rritur jetëgjatësinë e tyre.

Rekomandimi 9.2: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ti kërkoj Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa për regjistrimin në Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM)/hapin kartelat e shërbimit për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj.).

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Ne audituam përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi, të projektit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për veprimtarinë nga fillimi i projektit deri në datën 31.12.2013, sa i takon zbatimit të marrëveshjes së financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre, shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit, menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar, raportimi i tyre në Ministrinë e Financave, zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit, ose legjislacionin shqiptar.

Opinion i modifikuar (kualifikuar) mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se gjatë aktivitetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e projektit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, situatë e cila justifikon dhënien e një opinioni të modifikuar (kualifikuar), e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e modifikuar (kualifikuar):

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899). Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinioni. Nga evidencat e marra për veprimtarinë e MSHMS për projektin “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” rezultuan parregullsitë si vijon:

- Vonesa të pajustificuara në implementimin e programit, të cilat kanë ardhur kryesisht nga pala shqiptare pasi, nga viti 2006 deri në vitin 2014 për projektin nuk rezultoi të jetë zhvilluar asnjë aktivitet për të vënë në lëvizje strukturat kompetente të cilat do të siguronin zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja dhe arritjen në kohë të objektivave të projektit.

- Implementimi real i tij ka filluar në vitin 2014 kur janë evidentuar nevojat fillestare të spitalit nga eksperti italian i Cooperazione Italiana, ndërsa realizimi i procedurave të prokurimit ka filluar në vitin 2015. Nga ky moment deri në përfundim të projektit kanë kaluar 5 vjet dhe rezultati i arritur nga projekti është i ndarë në përpjesëtim jo të drejtë në vite, pasi edhe gjatë fazës së zbatimit të kontratave me operatorët ekonomik fitues, projekti nuk ka vazhduar për shkak të rikonstruksionit të Spitalit Universitar të Traumës, fakt i cili ka ndikuar në një tjetër vonesë për realizimin sa më të shpejt të tij.

- Nuk ka një ndarje të qartë në lidhje me shumat që janë akorduar për secilin nga komponentët e projektit, nuk është hartuar raporti përfundimtar i vlerësimit të projektit dhe nuk mund të evidentohet ndarja e këtyre zërave sipas kontratave të lidhura, pasi në një prej kontratave të lidhura mund të jene përfshirë pajisje që u shërbejnë 2 ose më shumë loteve, të cilat në vetvete përfshinë pajisje që mund t'i përkasin komponentëve të ndryshëm. Për shkaqet e mësipërme, edhe pse implementimi dhe marrja në dorëzim e pajisjeve ka përfunduar, nuk mund të shprehemi mbi arritjen e objektivit specifik të projektit.

- Nuk ka dokumentim të të gjitha fazave të implementimit të projektit, në ruajtjen e dokumentacionit, si dhe në ndjekjen dhe monitorimin e projektit nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për menaxhimin e tij, në mos përputhje me përcaktimin e sanksionuar në Marrëveshjen bazë.

- Objektivit i projektit: pajisja me aparatura mjekësore duke e bërë atë të përshtatshme si pikë referimi për pacientët e traumatizuar është realizuar edhe pse jo në kohë (*me mbi 16 vjet vonesë nga marrëveshja fillestare*).

Nga spitali i traumës si përfituesi direkt i kredisë së ndihmës nuk është hartuar raporti i vlerësimit përfundimtar mbi realizimin e objektivave specifik, në zbatim të nenit 15, pika 5 e të Ligjit nr. 9617, datë 16.10.2006.

- Nuk është ngritur komiteti drejtues e për pasojë asnjë nga detyrat të cilat citohen në nenin 6 të marrëveshjes së programit nuk rezultojnë të jetë kryer. Konkretisht rezultojnë se nuk është kryer monitorimi dhe vlerësimi i programit në të gjitha fazat e tij, nuk është kryer analiza përfundimtare e kontrollit të veprimtarive të programit. Si rrjedhojë sistemi i monitorimit të programit nuk ka funksionuar.

- Për shumat e përfituara nga kontraktorët e huaj nuk është vlerësuar/marrë në konsideratë mbajtja e tatimit mbi të ardhurat në vlerën 749,475 euro vlerë e cila përfshin pagesat e kryera për kontraktorët. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale dhe kontraktorët/ kompanitë Italiane, nuk kanë aplikuar dhe dorëzuar në organet tatimore formularët për eliminimin e tatimit të dyfishtë.

- Nga pajisjet mjekësore të furnizuara për periudhën 2019-2020 u inspektuan 17 të tilla me vlerë 210,952 euro. Për këto pajisje mjekësore të instaluar nuk ka gjurmë auditimi (dokumentare), për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM)/kartela e shërbimit për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj.).

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 134/1, prot. datë 08/02/2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08/02/2024 deri në datën 08/03/2024, në subjektin Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën nga fillimi i projektit deri në datën 31/12/2023, u krye auditimi “Mbi auditimin e Përputhshmërisë për projektin “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. I. S. (Përgjegjëse grupi),
2. F. I., anëtar,
3. J. B., anëtar.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Dhënia e opinionit dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve si dhe nëse është kryer përdorimi i përshtatshëm i fondeve të projektit.

2. Identifikimi i çështjes:

Për realizimin e projektit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” është lidhur marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 9617, datë 16.10.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës", në formën e kredisë ndihmëse në shumën 5,000,000 Euro dhe një donacion në shumën 150,000 Euro. Bazuar në këtë marrëveshje është nënshkruar Marrëveshja Financiare midis Ministrisë së Financave dhe Artigiancassa Spa ratifikuar me Ligjin nr.9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa spa për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

Programi përmban dy objektiva bazë (Objektivat e Programit) të cilët janë:

1. Objektivi i përgjithshëm i Programit është i vetëm dhe qëndron në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të popullsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë të popullsisë së prekur nga trauma, si dhe
2. Objektivat specifik të cilët kërkojnë të bëjnë më eficientë e më efikase veprimtarinë terapeutike të Qendrës Traumatologjike Kombëtare, duke rritur në këtë mënyrë ndikimin mbi shëndetin e popullsisë dhe njëkohësisht për të përmirësuar prognozën *quod valitudinem* të pacientëve politraumatikë me pasojë uljen e paaftësive të përkohshme dhe të përhershme dhe të kostove që lidhen me to.

Programi synon të arrijë pajisjen e Qendrës Traumatologjike Kombëtare me aparaturat e duhura mjekësore dhe ta bëjë atë të përshtatshme për rolin që ajo ka si pikë referimi kombëtare për pacientët e traumatizuar.

Zbatimi i Programit shpie në furnizimin me:

- pajisje mjekësore dhe orendi;
- një shërbim asistence teknike, mirëmbajtje dhe trajnimi të specializuar;
- përpos garancisë së zakonshme të pajisjeve;
- një sasi të përshtatshme materialesh konsumi për QTK.

Në bazë të nenit 5 “Burimet financiare dhe Modalitetet e përdorimit të kredisë së ndihmës”, parashikohet:

a) Burimet financiare të nevojshme për realizimin e Programit janë si vijon:

1. Kredia ndihmëse prej 5,000,000 Euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në Program.

2. Donacion prej 150,000 euro për veprimtaritë e kontrollit dhe asistencës teknike si gjatë shpalljes së tenderave, ashtu dhe gjatë zbatimit të veprimtarive të Programit.

b) Afatet dhe kushtet e kredisë ndihmëse janë si vijon:

- periudha e kthimit të kredisë: 19 vjet

- periudha e faljes (për kthimin e kredisë): 8 vjet

- përqindja e interesit vjetor: 0.20%.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë përgjegjëse për implementimin e projektit, mirë menaxhimin dhe hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për zbatimin e tij.

4. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me implementimin e projektit shkallën e realizimit të objektivave etj.. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

5. Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH.

- Ligj nr. 9656, datë 11.12.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa spa për financimin e programit “Fuqizimi i qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

- Ligji nr. 84/2017 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa, s.p.a., për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”

- VKM nr. 116, datë 24.02.1997 “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”.

- VKM nr. 452, datë 01.07.1998 “Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huaj”;

- VKM nr.600, datë 31.8.2006 “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa, spa për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”

- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”;

- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 20, datë 24.12.2003 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”;

- Udhëzuesit e prokurimit të huadhënësit për prokurimet e fondeve për mallra, punime dhe shërbime.

Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

6. Standardet e auditimit:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC, etj.

7. Metodatat e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm, me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

8. Dokumentimi i auditimit:

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara akt konstatimeve dhe akt verifikimeve, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar do të përgatitet Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 134/1, prot. datë 08/02/2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08/02/2024 deri në datën 08/03/2024, në subjektin Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën nga fillimi i projektit deri në datën 31/12/2023, u krye auditimi “Mbi auditimin e Përputhshmërisë për projektin “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”. Projekti “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Shqiptare të Tiranës” është audituar pjesërisht nga KLSH në vitin 2018. Projekti deri në fund të periudhës së auditimit kishte përfunduar zbatimin e tij në terren, por në lidhje me disbursimet (pagesat) ishte në masën 80%.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 134/1, datë 08/02/2024 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve.
2. Dokumentacioni i vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga auditimi rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

Subjekti Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka kthyer përgjigje në KLSH në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për rekomandimet e lëna për projektin “*Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës*”.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për projektin “*Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës*”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka përmbushur detyrimin e afatit 6-mujor të raportimit, pasi ka kthyer një përgjigje në KLSH me shkresën nr. 2934 datë 19.06.2020 “Kthim përgjigje shkresës 1417/8 datë 09.08.2019” por ka përcjell vetëm planin e masave.

Ministri i Shëndetësisë në planin e masave të hartuar për secilën masë ka përcaktuar drejtoritë dhe personat përgjegjës së bashku me afatin për zbatimin e detyrave të rekomanduara në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtarë të KLSH për projektin “*Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës*”.

III. Rekomandimet e KLSH

- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. 1417/8 datë 09.08.2019, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime;
- b. Janë rekomanduar **12 masa organizative nga të cilat 1 është zbatuar dhe 11 nuk janë zbatuar**;

c. Janë rekomanduar 6 masa për shpërblim dëmi në vlerën 795,351.86 euro pa TVSH nga të cilat janë zbatuar 0 masa me vlerë 0 lekë dhe janë pa zbatuar 6 masa në vlerën 795,351.86 euro;

e. Është rekomanduar 1 masë disiplinore e cila rezulton e pazbatuar.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar (numër)	Pranuar Plotësisht (numër)	Pranuar pjesërisht (numër)	Pa pranuar (numër)
1	Përmirësim ligjor	-	-	-	-
2	Organizative	12	12	-	-
3	Shpërblim dëmi	6	6	-	-
4	Masa disiplinore	1	1	-	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e ADISA

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar Plotësisht (numër)	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	0	0	0	0	0
2	Organizative	12	1	0	0	11
3	Shpërblim dëmi	6 795,351.86 euro	0	0	0	6 795,351.86 euro
4	Masa disiplinore	1	0	0	0	1

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes nuk kanë zbatuar përcaktimet e marrëveshjeve për fuqizimin e Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës lidhur me institucionin kompetent për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe ato lidhur me përqindjen e kredisë së ndihmës që do të përdorej për kosto lokale dhe/ose në vendet në zhvillim, por kanë zbatuar ndryshimet e marrëveshjes qeveritare ende pa hyrë në fuqi këto ndryshime.

Konstatohet se procedurat e prokurimit (1 procedurë me 7 lote) janë zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë e cila bazuar në ligjet në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave, nuk e kishte një kompetencë të tillë, si dhe në dokumentet që përcaktojnë kriteret dhe procedurën e prokurimit është përcaktuar një përqindje më e lartë e kredisë së ndihmës për kosto lokale dhe/ose në vendet e OECD-së, duke zbatuar, pa hyrë ende në fuqi, parashikimet e ndryshimeve të marrëveshjes qeveritare, të cilat u ratifikuan nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 21.12.2015 dhe u botuan në fletoren zyrtare nr. 246, datë 21.01.2016, ndërkohë që njoftimi për fillimin e procedurave të prokurimit u bë më 29.07.2017 dhe akti i fitimit provizor të këtyre procedurave u lëshua më 26.11.2015. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 31-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Para zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ndryshimeve të tyre duhet të merret konfirmim nga sektori përkatës i këshillimit ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me momentin e hyrjes në fuqi të dispozitave përkatëse që ju kalojnë ose heqin strukturave të tyre kompetencat juridike lidhur me zbatimin e projekteve, me qëllim shmangien e këtyre praktikave në të ardhmen.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se ka pas vonesa të shumta në implementimin e programit të cilat kanë ardhur kryesisht nga pala shqiptare pasi nga fillimi i tij deri në vitin 2014 për projektin nuk rezultoi të jetë zhvilluar asnjë aktivitet për të vënë në lëvizje strukturat kompetente të cilat do të siguronin zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja pra, mund të themi se ky projekt për një periudhë të gjatë nuk ka funksionuar duke rezultuar në gjendje të fjetur edhe pse një vonese e tillë nuk ka pasur efekt financiar ka ndikuar në arritjen në kohë të objektivit kryesor të tij i cili është i vetëm dhe qëndron në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të popullsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë të popullsisë së prekur nga trauma, si dhe objektivave specifik të cilët kërkojnë të bëjnë më efikasitet dhe më efikasitet veprimtarinë terapeutike të Qendrës Traumatologjike Kombëtare, duke rritur në këtë mënyrë ndikimin mbi shëndetin e popullsisë dhe njëkohësisht për të përmirësuar prognozën shëndetësore të pacientëve politraumatikë me pasojë uljen e paaftësive të përkohshme dhe të përhershme dhe të kostove që lidhen me to.

Referuar shkresës nr. 1179/29 datë 23.11.2016, *implementimi real i tij ka filluar në vitin 2014* kur janë evidentuar nevojat fillestare të spitalit nga eksperti italian i Cooperazione Italiana, ndërsa realizimi i procedurave të prokurimit ka filluar në vitin 2015. Nga ky moment deri në momentin e auditimit ka kaluar një periudhë më shumë se 4 vjet dhe rezultati i arritur nga projekti është i ndarë në përpjesëtim të zhdrejtë në vite, pasi edhe gjatë fazës së zbatimit të kontratave me operatorët ekonomik fitues, projekti nuk ka vazhduar për shkak të rikonstruksionit të Spitalit Universitar të Traumës. Fakt i cili ka ndikuar në një tjetër vonesë për realizimin sa më të shpejt të tij, e cila ka ndikuar drejtpërdrejtë në synimin kryesorë të Programit, pajisjen e Qendrës Traumatologjike Kombëtare me aparataturat e duhura mjekësore për ta bërë të përshtatshme për rolin që ajo ka si pikë referimi kombëtare për pacientët e traumatizuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Njësia e Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me Spitalin Universitar të Traumës, të marrin masa për hartimin e një raporti përfundimtar të implementimit të projektit, ku të analizohen realizimi i objektivave specifik dhe ku të përcaktohen me hollësi shkaqet, arsyet dhe të jepen argumentet për vonesën e realizimit të projektit, si dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të përcaktohen masat e nevojshme dhe përgjegjësit konkret për përfundimin e gjithë aktiviteteve të mbetura të projektit.

Menjëherë

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka një ndarje të qartë në lidhje me shumatat që janë akorduar për secilin nga komponentët e projektit, nuk është hartuar raporti përfundimtar i vlerësimit të projektit dhe nuk mund të evidentohet ndarja e këtyre zërave sipas kontratave të lidhura, pasi në një prej kontratave të lidhura mund të jenë përfshirë pajisje që u shërbejnë 2 ose më shumë loteve të cilat në vetvete përfshinë pajisje që mund t'i përkasin komponentëve të ndryshëm. Edhe pse implementimi dhe marrja në dorëzim e pajisjeve ka përfunduar nuk mund të specifikojmë arritjen e objektivit specifik të projektit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Njësia e Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me spitalin e traumës të ngrejë një grup pune i cili të ndajë sipas komponentëve të projektit të gjitha pajisjet mjekësore në bazë të kontratave të lidhura, me qëllim evidentimin e saktë të tyre për të qartësuar përmbushjen e komponentëve dhe objektivave specifik të programit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Programi referuar marrëveshjes duhet të monitorohej përmes një komiteti drejtues, i përbërë nga dy anëtarë të caktuar, njëri nga MPJ/DPKZH dhe tjetri nga MM (ndryshuar në MSH sipas marrëveshjeve të sipërpërmendura). Nga auditimi rezultoi se një komitetit i tillë nuk është ngritur dhe për pasojë asnjë nga detyrat të cilat citohen në nenin 6 të marrëveshjes së programit nuk rezulton të jetë kryer. Ka munguar monitorimi dhe vlerësimi i programit në të gjitha fazat e tij. Nuk ka takime pune ku të evidentohen propozimet e bëra për realizimin e programit dhe nuk ka vendime të këtij komiteti në lidhje me faza të ndryshme të ecurisë së programit. Nuk rezulton asnjë analizë përfundimtare të kontrollit të veprimtarive të programit. Si rrjedhojë sistemi i monitorimit të programit nuk ka funksionuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1 Rekomandime: MSHMS për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të administrohen nga ana e saj në të ardhmen t'i përmbahet marrëveshjeve bazë financiare si dhe programit të financimit duke ngritur strukturat përkatëse të monitorimit të përcaktuara në to me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e projektit si dhe evidentimin e problemeve në faza të ndryshme të programit me qëllim rritjen e efektivitetit të projekteve me financime të huaja.

Në vazhdimësi

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me këtë projekt ekziston një boshllëk në dokumentimin e të gjitha fazave të implementimit të tij, në ruajtjen e dokumentacionit, si dhe në ndjekjen dhe monitorimin e projektit nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për menaxhimin e tij, në përputhje me përcaktimin e sanksionuar në Marrëveshjen bazë, ku përcaktohet se MSH duhet të kujdeset për koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe menaxhuese të nevojshme për realizimin e programit. Detyrat për menaxhimin e projektit nuk ka qenë e deleguar dhe e mirë përcaktuar nga ana e institucioneve shqiptare të përfshira në implementimin e tij (MM dhe MSH), ky projekt ka mangësi të theksuar si në dokumentacionin e fazave të zhvillimit ashtu edhe në mbledhjen, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve fizik dhe letrave të punës për periudhën nga fillimi i tij deri më datë 11.11.2014, kur me urdhrin e MSH është ngritur njësi për procedurën e prokurimit dhe KVO. Edhe gjatë fazës së implementimit të tij nga Ministria e Shëndetësisë kur janë caktuar drejtuesit e programit, nuk janë caktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të përfshirë në implementimin e projektit dhe dorëzimi i dokumentacionit nga njëri staf në tjetrin nuk është dokumentuar dhe zhvilluar sipas procedurave të kërkuara nga aktet ligjore në fuqi, konkretisht VKM nr. 124 datë 17.02.2016, i ndryshuar, në nenet 27,28,29,30 të tij. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1 Rekomandimi: MSHMS për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të administrohen nga ana e saj në të ardhmen t'i përcaktojë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të përfshirë në implementimin e projektit në përputhje me marrëveshjet përkatëse, me qëllim monitorimin e projektit dhe nxjerrjen e përgjegjësive në rastet e vonësive të mundshme si dhe dorëzimi i dokumentacionit në rastet e ndërrimit të stafit të dokumentohet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment: Referuar periudhës së auditimit për këtë 01.01.2019 – fund të projektit nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga palët përgjegjëse për zbatimin e projektit, nuk është përcaktuar një afat për përfundimin e projektit, si dhe një grafik kohe për jetëgjatësinë dhe ecurinë në vite, nuk është hartuar një dokument i vlerësimit të projektit (PAD), veprime të cilat kanë sjellë një zvarritje të tij (projektit). Midis dy palëve MSHMS dhe palës italiane, për ndalimin e projektit nuk është bërë një riaktivizim i projektit apo një program që cakton radhën e veprimeve në vazhdimësi, veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të Marrëveshjes së kredisë, ku përcaktohet se nëse zgjatja e pengesave është më e madhe se 24 muaj, palët janë të detyruara të bien dakord mbi vazhdimin e projektit dhe të caktojnë radhën e veprimeve. Nga situata dhe nga ecuria e projektit, mund të gjykojmë se për këtë projekt koha e implementimit dhe rezultatet e prekshme, janë në raport të zhdrejtë me njëri-tjetrin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi: MSHMS për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të administrohen nga ana e saj në të ardhmen t'i përmbahet marrëveshjeve bazë financiare si dhe programit të financimit si dhe të caktojnë një afat kohor ku të përcaktohen radha e veprimeve në vazhdimësi, veçanërisht në rastet e riaktivizimit të kredisë.

Në vazhdimësi

Koment: Referuar periudhës së auditimit për këtë 01.01.2019 – fund të projektit nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Për realizimin e projektit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” është lidhur marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 9617, datë 16.10.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës", në formën e kredisë ndihmëse në shumën 5,000,000 Euro dhe një donacion në shumën 150,000 Euro.

Bazuar në këtë marrëveshje është nënshkruar Marrëveshja Financiare midis Ministrisë së Financave dhe Artigiancassa Spa ratifikuar me Ligjin nr. 9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa spa për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

Në nenin 9 “Detyrime të Qeverisë Shqiptare” parashikohet që Qeveria Shqiptare merr përsipër:

- të vërë në dispozicion burimet financiare në kompetencë të saj, të barabarta me rreth 1,000,000.00 Euro të barsvlershme;
- t'i bëjë operative të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet zyrtare të domosdoshme për përfundimin me sukses të Programit;
- të bashkëpunojë me MPJ/DPKZH për veprimtaritë e monitorimit të Programit, sipas nenit 6, edhe që kjo e fundit të mund të ketë akses ndaj dokumentacionit ekzistues dhe në hapësirat ku ai vepron.

Gjatë periudhës së auditimit edhe pse ka pasur kërkesa të vazhdueshme grupit të auditimit nuk ju vendosë në dispozicion dokumentacion i mësipërm me qëllim vlerësimin e plotësimin të kërkesave nga ana e qeverisë shqiptare dhe afatet e plotësimin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 48-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me gjithë institucionet e përfshira për realizimin e projektit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” të marrë masa që të administrojë të gjithë dokumentacionin e projektit si dhe në mënyrë të veçantë gjithë dokumentacionin në lidhje me plotësimin e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë për të evidentuar qartë hyrjen në fuqi të marrëveshjes financiare dhe shkakun e vonesave, duke krijuar një kuadër të plotë dokumentar dhe arkivor për projektin.

Koment: Referuar periudhës së auditimit për këtë 01.01.2019 – fund të projektit nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Për të rregulluar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Programit dhe mënyrën sesi do të zbatohet financimet që lidhen me huanë e butë është nënshkruar marrëveshja financiare ratifikuar me Ligjin nr. 9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa Spa për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës" ku janë përcaktuar më qartë termat e financimit të kredisë dhe shlyerja e saj, konkretisht shuma maksimale e kredisë 5,000,000 Euro me kohëzgjatje 19 vjet dhe shlyerja e kredisë në 22 këste të principalit të barabarta gjysmë-vjetore të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve bëhet i pagueshëm 102 (njëqind e dy) muaj prej datës së disbursimit të parë me normë interesit nominale 0.20% në vit (zero pikë njëzet për qind) e pagueshme në fund të çdo periudhe të 6 (gjashtë) muajve prej datës së çdo tërheqjeje. Në zbatim të këtij neni të marrëveshjes deri në fund të 31.12.2018 u konstatua se janë disbursuar 4,053,612.95 Euro dhe interesi i paguar për këtë shumë është 3,648.52 Euro. Referuar nenit 4 "Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare".

4.1 Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive pasi Artigiancassa të ketë marrë prej Huamarrësit dokumentet e mëposhtme përmes Ambasadës Italiane - Ambasada/Zyra e bashkëpunimit:

i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke pasqyruar autoritetin e Huamarrësit për të nënshkruar në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë këtë Marrëveshje nga një person i autorizuar në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe vepruese në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet e lindura nga kjo Marrëveshje;

ii) Emërimin me shkrim nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë të personit/personave të autorizuar në mënyrë të rregullt për të nënshkruar këtë Marrëveshje (të vërtetuar nga Ambasada Italiane në Tiranë – Ambasada/Zyra e bashkëpunimit), kërkesa për financim e kontratës së furnizimit në formularin e shtojcës A) dhe njohjen e borxhit në formularin e shtojcës C) referuar nenit 10 më poshtë. Ky përcaktim do të specifikojë emrin dhe zyrën e këtij personi/personave dhe të përmbajë "modelin" e përditësuar të firmave të tyre. Ndonjë ndryshim i kësaj (nëse ka) do të transmetohet në kohë nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë tek Artigiancassa;

iii) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me caktimin e Bankës Agjente Shqiptare, duke i kërkuar autoritetit të Bankës Agjente Shqiptare të veprë në emër dhe për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Pasi të ketë marrë dokumentet e lartpërmendura dhe të jetë në pajtim të plotë me to, Artigiancassa do të njoftojë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Shqiptare Agjente me anë të një letre ose faksit, që më pas do të konfirmojë me anë të letrës, datën në të cilën kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi.

Dokumentacioni i mësipërm, nuk ju vendos në dispozicion grupit të auditimit për të gjykuar mbi plotësimin e kushteve dhe saktësimin e datës së bërjes efektive të kredisë, me gjithë insistimin dhe kërkesën zyrtare për dokumentacion të grupit të auditimit protokolluar në Ministri me nr. 05/3, datë 17.01.2019. Ministria dhe PIU komunikojnë me Bankën Agjente, por nuk ka asnjë dokument zyrtar që përcakton këtë Bankë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 48-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa që të administrojë të gjithë

dokumentacionin e projektit si dhe në mënyrë të veçantë gjithë dokumentacionin në lidhje me anën financiare dhe institucionet agjente në Shqipëri.

Menjëherë dhe në Vijimësi

Koment: Referuar periudhës së auditimit për këtë 01.01.2019 – fund të projektit nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se për periudhën objekt auditimi personat e autorizuar për të firmosur janë ndryshuar pesë herë dhe me shkresat përkatëse janë përcjell në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Grupit të auditimit deri në fund të periudhës së auditimit (datë 28.02.2019) nuk ju vendosën në dispozicion shkresat e Ministrisë së Financave për përcjelljen e firmave të deleguara në Bankë, por konstatohet nga komunikimi elektronik me Bankën që vonesat e përcjelljes së firmave të personave të autorizuar janë deri në 4 muaj. Vonesa të tilla kanë sjell edhe vonesa në kryerjen e pagesave dhe për rrjedhojë rritjen e riskut për penalizime të mundshme për palën shqiptare, për vonesa në pagesat e kontraktorëve sipas kushteve të kontratave të lidhura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 48-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Rekomandimi 9.1 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa që në të ardhmen për projektin "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës" dhe për të gjitha projektet me financimet e huaja të përshpejtojnë depozitimin e firmave të personave të autorizuar duke eliminuar riskun e penalizimeve si pasojë e pagesave të vonuara.

Koment: Me shkresën nr. 2934 prot datë 19.06.2020 të MSHMS, në përputhje me rekomandimet e lëna nga KLSH, është dërguar plani i punë mbi zbatimin e projektit "Fuqizimi i qendrës Traumatologjike Shqiptare" ku për këtë pikë është ngarkuar Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e saj. Është marrë në konsideratë që për projektet në të ardhmen t'i jepet përparësi depozitimit të firmave. Nuk u konstatuan penalitete për pagesa të vonuara.

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Referuar Nenit 3 të Ligjit nr. 9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa Spa për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës" huaja e butë nuk mund të përdoret për të financuar taksat lokale, taksat doganore dhe TVSH-në.

Për këtë qëllim Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paguar TVSH në doganë për të gjitha dërgesat e kryera nga kompanitë italiane në Republikën e Shqipërisë. Deri në fund të periudhës së auditimit janë kryer gjithsej 34 pagesa për TVSH në total 129,214,756 lekë.

Nga auditimi u konstatua se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i ka paguar direkt në doganë detyrimet për TVSH në emër dhe për llogari të kontraktorëve, ndërkohë që nuk është siguruar që TVSH e mallrave që Ministria po paguan është për mallrat që janë objekt i kontratës dhe që janë sipas specifikimeve të kontratave. TVSH duhet të paguhej nga vetë kontraktorët duke hapur një NIP-t sekondar ose duke e deleguar tek një përfaqësues tatimor në Republikën e Shqipërisë, dhe vetëm pas instalimit dhe marrjes në dorëzim dhe konfirmimit bankar për pagesën e kryer të TVSH Ministria duhet të rimbursonte pagesën e kryer, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 86, 87 dhe 88 të Ligjit Nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 48-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa që mos të kryejë asnjë pagesë për TVSH në doganë për projektet me financime të huaja, por ta rimbursojë

pagesën e saj vetëm pas marrjes në dorëzim të mallrave duke u siguruar që mallrat e ardhur përputhen me mallrat e kërkuara në kontratë.

Menjëherë dhe në Vijimësi

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultuan shkelje të parashikimeve juridike lidhur me dokumentimin e veprimtarisë, marrjen në dorëzim të dokumentacionit, arkivimin e dokumentacionit. Rezultoi se ***nuk disponohet asnjë lloj dokumentacioni nga fillimi i projektit deri në fazën e tenderit.*** Në MSHMS nuk disponohet asnjë dokumentacion i cili të sqaroje procedurën e ndjekur për hartimin e nevojave të qendrës së traumës. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit do të duhej të ishte bërë nga MM (*ndryshuar në MSH me ligjin 153/2015*) e cila duhet të përgatiste dokumentacionin e tenderit për përzgjedhjen e fituesve dhe t'ia përcillte/ambasadës/ZTL me kërkesën për të botuar shpalljen e tenderëve në gazetën italiane. Grupi i auditimit në lidhje me dokumentacionin e hershëm të projektit u interesua edhe në Ministrinë e Mbrojtjes si dhe në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura pranë Ministrisë së Mbrojtjes nga ku rezultoi se, nuk disponohet asnjë dokumentacion nga këto organe në lidhje me projektin “**Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtar të Tiranës**”. Nga auditimi rezultoi se përgatitja e dokumenteve të tenderit është bërë nga ekspert italian, por, nuk na u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për të evidentuar punën e tyre, se cili është produktiviteti i tyre si konsulent mbi hartimin e nevojave për realizimin e programit

Në dosjen e vlerësimit të procedurës së garës mungojnë formularët e vlerësimit sipas kërkesave bazë të dokumenteve standard (*dossier di gara*) të cilët duhet të ishin bashkëlidhur me procesverbalet e mbajtur dhe të firmosur nga KVO si dhe mungojnë e-mail-et me të cilat personi i ngarkuar nga KVO i është drejtuar subjekteve të ndryshme duke i kërkuar dokumentacion sqarues në lidhje me formularët e dorëzuar, veprime të cilat janë në kundërshtim me marrëveshjet e financimit të projektit të ndryshuara dhe Dokumentet e Tenderit, neni 12 seksioni C. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 61-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

11.1 Rekomandime: MSHMS/Drejtoria Përkatëse e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve dhe dokumenteve të procedurave të prokurimit publik për procedurat e zhvilluara për projektin “**Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtarë të Tiranës**”, në zbatim të Normave Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, të respektohen në çdo rast nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale parashikimet juridike lidhur me arkivimin e dokumentacionit, si dhe të vendosen në çdo rast në dispozicion të grupeve të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacioni i kërkuar.

Deri në përfundimin e gjithë veprimtarive të projektit

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

11.2 Rekomandime: MSHMS/Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve të marrë masa që në të ardhmen për projektet me financime të huaja dhe procedura prokurimi ndërkombëtare të hartojë, plotësojë dhe administrojë formularët sipas dokumenteve standarde të tenderëve të miratuara paraprakisht si dhe të administrojë dokumentacionin e plotë ligjor sipas përcaktimeve të marrëveshjeve përkatëse që nga faza e hyrjes në fuqi të tyre deri në përfundimin e zbatimit të kontratave.

Në vijimësi

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar

B.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kuadrit ligjor tatimor të Republikës së Shqipërisë u konstatua se asnjë nga kontraktorët nuk ka paguar detyrimet për tatimin e fitimit në Republikën e Shqipërisë dhe as nuk kanë aplikuar dhe dorëzuar për eliminimin e tatimit të dyfishtë sipas përcaktimeve të pikës 4.3 të Udhëzimit nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal” dhe shtojcave përkatëse, konfirmuar kjo edhe nga komunikimi zyrtar me e-mail me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

-Kontrata e lidhur me *I. S.* për le Infrastrutture Sociali S.p.a për projektin "Fuqizimin e Qendrës Traumatologjike Kombëtare, Tiranë" lotet 1,3,5 dhe 6 sipas kontratës nr. 1179/16 datë 30.03.2016 me vlerë kontrate 2,313,621.95 Euro, me certifikate marrje në dorëzim të përkohshme nr. 2612/15 datë 15.11.2017. Me shtesën e kontratës nr. 970/4 datë 07.03.2017 është miratuar shtesa në vlerën prej 571,712.29 euro ose 24.71 % e kontratës bazë, me certifikate marrje në dorëzim të përkohshme nr. 3251/3 datë 14.06.2018. Deri në fund të periudhës objekt auditimi pagesa e kryer është 2,313,621 Euro. Totali i detyrimit për të ardhurat e krijuara në Republikën e Shqipërisë dhe të papaguara është **347,043.3 Euro**.

- Kontrata e lidhur me *A. Italy S.p.a* për projektin "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare, Tiranë" loti 7 sipas kontratës nr. 1179/18 datë 11.04.2016 me vlerë kontrate 455,230 Euro, me certifikate marrje në dorëzim të përkohshme nr. 2612/15 datë 15.11.2017. Me shtesën e kontratës nr. 970/3 datë 24.02.2017 është miratuar shtesa në vlerën prej 90,640 Euro ose 19.9 % e kontratës bazë, me certifikate marrje në dorëzim të përkohshme nr. 3251/1 datë 16.05.2018. Deri në fund të periudhës objekt auditimi pagesa e kryer është 545,870 Euro. Totali i detyrimit për të ardhurat e krijuara në Republikën e Shqipërisë dhe të papaguara është **81,880.5 Euro**.

-Kontrata e lidhur me *A. Srl (ex C. M. S. Spa)*, Itali për projektin "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare, Tiranë" loti 4 sipas kontratës nr. 1179/13 datë 25.03.2016 me vlerë kontrate 636,750 Euro, me certifikate marrje në dorëzim të përkohshme nr. 3826/2 datë 22.06.2018. Me shtesën e kontratës nr. 970/2, datë 23.02.2017 është miratuar shtesa në vlerën 124,350 Euro ose 19.5% e kontratës. Deri në fund të periudhës objekt auditimi pagesa e kryer është 636,750 Euro. Totali i detyrimit për të ardhurat e krijuara në Republikën e Shqipërisë dhe të papaguara është **95,512.5 Euro**.

-Kontrata e lidhur me *VERNIPOLI s.r.l & TECNOSANIMED s.r.l* për projektin "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtarë, Tiranë" loti 2 sipas kontratës nr. 1179/15 datë 30.03.2016 me vlerë kontrate 557,371 Euro, me certifikate marrje në dorëzim të përkohshme nr. 3826 datë 14.06.2018. Me shtesën e kontratës nr. 970/1 datë 21.02.2017 është miratuar shtesa në vlerën prej 250,325.5 euro ose 44.91 % e kontratës bazë, me certifikate marrje në dorëzim të përkohshme nr. 3826/3 datë 24.09.2018. Deri në fund të periudhës objekt auditimi pagesa e kryer është 557,371 Euro.

Totali i detyrimit për të ardhurat e krijuara në Republikën e Shqipërisë dhe të papaguara është 83,605.65 Euro.

Në total 608,041.95 Euro, përbën dëm ekonomik si detyrim i papaguar për buxhetin e shtetit për përfitimin e të ardhurave të realizuara në Republikën e Shqipërisë deri në 31.12.2018, theksojmë që janë edhe tre pagesa për shtesat e kontratave që ende nuk janë paguar, detyrim i cili në qoftë se nuk paguhet nga ana e kontraktorëve do t'i ngarkohet MSHMS në bazë të ligjit të tatimeve të cituar më sipër. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 48-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **608,041.95 Euro** ndaj kontraktorëve si pagesë e munguar për tatim fitimin për të ardhurat e realizuara në

Republikën e Shqipërisë dhe ta derdhi këtë shumë pranë organeve tatimore, konkretisht sipas vlerave të mëposhtme:

-I. S. për le Infrastrutture Sociali S.p.a në vlerën 347,043.3 Euro

-A. Italy S.p.a në vlerën 81,880.5 Euro

-A. Srl (ex C. M. S. Spa), Itali në vlerën 95,512.5 Euro

-VERNIPOLI s.r.l & TECNOSANIMED s.r.l në vlerën 83,605.65 Euro

Menjëherë

Koment: Me shkresën nr. 2934 datë 15.07.2020 Ministria e Shëndetësisë i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit asistencë teknike lidhur me hartimin e kërkesë padisë dhe përgatitjen e mbrojtjes për MSHMC për të ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës referuar rekomandimit të KLSH. Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2863/3 prot datë 25.8.2020 ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë informacion ligjore në lidhje me dëmin e nxjerrë nga KLSH për të vazhduar më tej me procesin. Deri në fund të periudhë auditimit nuk u vendosën dokumentacion shtesë në dispozicion.

Ministria në mos përgjigje nga Avokatura e Shtetit, nuk i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për interpretim lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për të dhënë argument shterues për mbajtjen ose jo të tatimit mbi të ardhurat, për të shmangur keq interpretimet e zbatimit të dispozitave të poshtë shënuara në lidhje me këtë çështje. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumenteve të përkthyer, me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentet e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit.

Pas 11 muajve nga dërgimi i raportit përfundimtar (nr. 1417/8 datë 09.08.2019) MSHMS ka kërkuar ekzekutim vullnetar kontraktorëve italian pas përfundimit të kontratave respektive dhe likuidimit të plotë (likuidimi i fundit 02.07.2020) ka kërkuar likuidim formalisht vullnetar në 07.07.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm G. P. (Assing Srl shkresa nr. 2934/2, datë 07.07.2020, I. Spa me shkresën nr. 2934/3, datë 07.07.2020, A. I. Srl me shkresën nr. 2934/4, datë 07.07.2020, V. Srl me shkresën nr. 2934/5, datë 07.07.2020). Formalitetet i cili provohet edhe nga kontraktorët Italian, konkretisht shprehen “Mbi të gjitha kontrata është mbyllur me procesverbal pranimi nga ana juaj, pa asnjë rezervë mbi veprimtarinë e kompanisë, por me konsideratë të lartë”.

Pas 2 viteve me shkresën nr. 133/4, datë 13.09.2022 “Kthim Përgjigje” nga dërgimi i dokumentacionit nga Ministria e Shëndetësisë, Avokatura e Shtetit është kontradiktore pasi nga njëra anë dërgon draft paditë, nga ana tjetër me emailin e datës 15.09.2022 shprehen:

“3. Duke pasur parasysh se marrëdhënia midis palëve në rastin konkret është kontradiktore dhe me qëllim mbrojtjen sa më efektive të argumenteve ligjorë të MSHMS –së, vlerësojmë se raporti i KLSH-së nuk mund të shërbejë në vetvete si shkak juridik padie.

4. Sugjerojmë një analizë të plotë të dispozitave kontraktore, provave dhe fakteve që ndihmojnë për të mbështetur pretendimet.”

I njëjti argument vlen edhe për Avokaturën e Shtetit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të kontratës nr. 1179/18 datë 11.04.2016 lidhur ndërmjet operatorit ekonomik A. I. Srl dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Lotin VII si dhe në Addendum Nr. 970/3 datë 24.02.2017 me vlerë 90,640 Euro u konstatua se në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk gjendet asnjë relacion nga ana e MSHMS apo nga ana e Spitalit Universitar të Traumës (SUT) pse lindi nevoja për këto pajisje shtesë e jo të tjera edhe pse në takimet me drejtorin e këtij spitali na u bë me dije se përzgjedhja e pajisjeve për kontratat shtesë u bë nga ana e ing. Italian i caktuar nga Coperazione Italiana për

përzgjedhjen e nevojave për SUT. Nga auditimi i zërave në Adendum u verifikua se 4 nga zërat e kësaj shtese nuk gjendet në kontratën bazë, si dhe njëri nga zërat **SOFTWARE 9733686 S7 SYNERGY SPINE** është dubluar me kontratën bazë duke sjellë një **dëm ekonomik në vlerën 32,000 Euro** dhe keq menaxhim të fondeve të kredisë nr. 8098.6 “Fuqizimi i Qendrës Kombëtare të Traumës” mes Shtetit Shqiptar dhe atij Italian.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 76-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **32,000 Euro** ndaj kontraktorit *A. I. Srl* si përfitim i paligjshëm.

Menjëherë

Koment: Me shkresën nr. 2934 datë 15.07.2020 Ministria e Shëndetësisë i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit asistencë teknike lidhur me hartimin e kërkesë padisë dhe përgatitjen e mbrojtjes për MSHMC për të ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës referuar rekomandimit të KLSH. Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2863/3 prot datë 25.8.2020 ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë informacion ligjore në lidhje me dëmin e nxjerrë nga KLSH për të vazhduar më tej me procesin. Deri në fund të periudhë auditimit nuk u vendosën dokumentacion shtesë në dispozicion. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Është vijuar edhe me njoftimin e operatorëve por pas përfundimit të kontratës. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer, me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Pas 11 muajve nga dërgimi i raportit përfundimtar (nr. 1417/8 datë 09.08.2019) MSHMS ka kërkuar ekzekutim vullnetar kontraktorëve italian pas përfundimit të kontratave respektive dhe likuidimit të plotë (likuidimi i fundit 02.07.2020) ka kërkuar likuidim formalisht likuidim vullnetar në 07.07.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm G. P. (*A. I. Srl* me shkresën nr. 2934/4, datë 07.07.2020). Formaliteti i cili provohet edhe nga kontraktorët Italian, konkretisht shprehen “*Mbi të gjitha kontrata është mbyllur me procesverbal pranë nga ana juaj, pa asnjë rezervë mbi veprimtarinë e kompanisë, por me konsideratë të lartë*”.

Pas 2 viteve me shkresën nr. 133/4, datë 13.09.2022 “Kthim Përgjigje” nga dërgimi i dokumentacionit nga Ministria e Shëndetësisë, Avokatura e Shtetit është kontradiktore pasi nga njëra anë dërgon draft paditë, nga ana tjetër me emailin e datës 15.09.2022 shprehen:

“3. Duke pasur parasysh se marrëdhënia midis palëve në rastin konkret është kontradiktore dhe me qëllim mbrojtjen sa më efektive të argumenteve ligjore të MSHMS –së, vlerësojmë se raporti i KLSH-së nuk mund të shërbejë në vetvete si shkak juridik padie.

4. Sugjerojmë një analizë të plotë të dispozitave kontraktore, provave dhe fakteve që ndihmojnë për të mbështetur pretendimet.”

I njëjti argument vlen edhe për Avokaturën e Shtetit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës nr. 1179/13 datë 25.03.2016 lidhur ndërmjet operatorit ekonomik *A. S. (e C. M. S. Spa)* dhe Ministrisë së Shëndetësisë me Mbrojtjes Sociale për Lotin IV, për produkte Radiologjie, u konstatua se:

Nga auditimi afateve të lëvrimit të mallit referuar nenit 4 të kontratës pika 7) **Dizenjo dhe kronogram** për paisjet me kod **i.01, i.02, i.03, i.06 dhe i.08** sipas këtij dokumenti afati maksimal pas bërjes aktive të kontratës e cila sipas shkresës nr. 1179/29 datë 29/12/2016 datë fillimi është 13.01.2017 dhe nga kjo datë operatori ekonomik sipas Kronogramës ka 40 ditë kohë maksimale për dërgimin e mallit në Shqipëri, praktikat doganore së bashku me transportin deri në SUT.

Sipas dokumentacionit në praktikën e pagesës malli ka mbërritur dhe ka dal nga dogana Shqiptare më 11.03.2017 pra 56 ditë pas datës 13.01.2017 ose 16 më vonë se afati maksimal i përcaktuar nga operatori ekonomik.

Në zbatim të kontratës mes palëve pika 7 “Afati i dorëzimit dhe penalitetet në vonesa” si dhe kushteve speciale të kontratës Aneksi III parashikuar në nenin 21 “Vonesa në ekzekutim-Penalitetet” parashikohet se:

Në rast vonese në dorëzimin e mallit, duke respektuar afatet e nënshkruara, operatori i paguan autoriteti kontraktorë një penalitet vonese në vlerën (0.20%) të vlerës së pajisjeve të pa furnizuara në kohë për çdo ditë vonesë deri sa të furnizohen.

Penaliteti i pa llogaritur dhe mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 357,336.25 Euro x 0.20% = 11,434.76 Euro e cila përbën dëm ekonomik** dhe duhet kërkuar operatorit ekonomik A. Srl (ex C. M. S. Spa). (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 76-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **11,434.76 Euro** ndaj kontraktorit A. Srl (ex C. M. S. Spa) si penalitete të pa llogaritura.

Menjëherë

Koment: Me shkresën nr. 2934 datë 15.07.2020 Ministria e Shëndetësisë i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit asistencë teknike lidhur me hartimin e kërkesë padisë dhe përgatitjen e mbrojtjes për MSHMC për të ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës referuar rekomandimit të KLSH. Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2863/3 prot datë 25.8.2020 ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë informacion ligjore në lidhje me dëmin e nxjerrë nga KLSH për të vazhduar më tej me procesin. Deri në fund të periudhë auditimit nuk u vendosën dokumentacion shtesë në dispozicion. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Është vijuar edhe me njoftimin e operatorëve por pas përfundimit të kontratës. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer, me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Pas 11 muajve nga dërgimi i raportit përfundimtar (nr. 1417/8 datë 09.08.2019) MSHMS ka kërkuar ekzekutim vullnetar kontraktorëve italian pas përfundimit të kontratave respektive dhe likuidimit të plotë (likuidimi i fundit 02.07.2020) ka kërkuar likuidim formalisht likuidim vullnetar në 07.07.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm G. P. (Assing Srl shkresa nr. 2934/2, datë 07.07.2020). Formaliteti i cili provohet edhe nga kontraktorët Italian, konkretisht shprehen “Mbi të gjitha kontrata është mbyllur me procesverbal pranë nga ana juaj, pa asnjë rezervë mbi veprimtarinë e kompanisë, por me konsideratë të lartë”.

Pas 2 viteve me shkresën nr. 133/4, datë 13.09.2022 “Kthim Përgjigje” nga dërgimi i dokumentacionit nga Ministria e Shëndetësisë, Avokatura e Shtetit është kontradiktore pasi nga njëra anë dërgon draft paditë, nga ana tjetër me emailin e datës 15.09.2022 shprehen:

“3. Duke pasur parasysh se marrëdhënia midis palëve në rastin konkret është kontradiktore dhe me qëllim mbrojtjen sa më efektive të argumenteve ligjorë të MSHMS –së, vlerësojmë se raporti i KLSH-së nuk mund të shërbejë në vetvete si shkak juridik padie.

4. Sugjerojmë një analizë të plotë të dispozitave kontraktore, provave dhe fakteve që ndihmojnë për të mbështetur pretendimet.”

I njëjti argument vlen edhe për Avokaturën e Shtetit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1179/15, datë 30.03.2016, lidhur midis BO V. Srl & T. Srl dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u

konstatuan mangësi në lidhje me zbatimin e afateve të lëvrimit të mallrave të kontratës konkretisht:

- Sipas dokumentacionit të praktikës së pagesës, malli ka mbërritur dhe ka dalë nga dogana Shqiptare më 22.03.2017 pra 69 ditë pas datës 13.01.2017 ose 25 ditë më vonë se afati maksimal i përcaktuar në kronogramë.

Në respektim të nenit 4 të kontratës, të dokumentacioni shoqërues të mallit si dhe referuar Kronogramës të cilat kanë një afat maksimal furnizimi prej 44 ditësh konstatohet se malli është lëvruar me 25 ditë vonesë kanë sjellë një penalitet të pa llogaritur dhe mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 220,647 Euro x 0.20% x 25 ditë = 11,032.35 Euro**.

- Sipas dokumentacionit shoqërues të pagesës mallrat janë furnizuar ditën e 75 ose me 31 ditë vonesë duke kanë sjellë një penalitet të pa llogaritur dhe mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 49,357 Euro x 0.20% x 31 ditë = 3,030.13 Euro**.

- Sipas dokumentacionit shoqërues të pagesës mallrat janë furnizuar ditën e 91 ose me 47 ditë vonesë kanë sjellë një penalitet të pa llogaritur dhe mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 48,547.5 Euro x 0.20% x 47 ditë = 4,563.4 Euro**

- Sipas dokumentacionit shoqërues të pagesës mallrat janë furnizuar ditën e 111 ose me 67 ditë vonesë kanë sjellë një penalitet të pa llogaritur dhe mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 41,997 Euro x 0.20% x 67 ditë = 5,627.6 Euro**

- Sipas dokumentacionit shoqërues të pagesës mallrat janë furnizuar ditën e 111 ose me 67 ditë vonesë kanë sjellë një penalitet të pa llogaritur dhe mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 26,912 Euro x 0.20% x 67 ditë = 3,606.2 Euro**

Në zbatim të kontratës mes palëve pika 7 “Afati i dorëzimit dhe penalitetet në vonesa” si dhe kushteve speciale të kontratës Anksi III parashikuar në nenin 21 “Vonesa në ekzekutim-Penalitetet” parashikohet se:

“Në rast vonese në dorëzimin e mallit, duke respektuar afatet e nënshkruara, operatori i paguan autoriteti kontraktor një penalitet vonese në vlerën (0.20%) të vlerës së paisjeve të pa furnizuara në kohë për cdo ditë vonesë deri sa të furnizohen.”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 76-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës **27.859.35 Euro** ndaj kontraktorëve *V. Srl & T. Srl* si penalitete të pa llogaritura dhe pa mbajtura.

Menjëherë

Koment: Me shkresën nr. 2934 datë 15.07.2020 Ministria e Shëndetësisë i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit asistencë teknike lidhur me hartimin e kërkesë padisë dhe përgatitjen e mbrojtjes për MSHMC për të ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës referuar rekomandimit të KLSH. Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2863/3 prot datë 25.8.2020 ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë informacion ligjore në lidhje me dëmin e nxjerrë nga KLSH për të vazhduar më tej me procesin. Deri në fund të periudhë auditimit nuk u vendosën dokumentacion shtesë në dispozicion. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Është vijuar edhe me njoftimin e operatorëve por pas përfundimit të kontratës. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer, me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Pas 11 muajve nga dërgimi i raportit përfundimtar (nr. 1417/8 datë 09.08.2019) MSHMS ka kërkuar ekzekutim vullnetar kontraktorëve italian pas përfundimit të kontratave respektive dhe likuidimit të plotë (likuidimi i fundit 02.07.2020) ka kërkuar likuidim formalisht likuidim vullnetar në 07.07.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm G. P. (*V. Srl* me shkresën nr. 2934/5, datë 07.07.2020). Formaliteti i cili provohet edhe nga kontraktorët Italian,

konkretisht shprehen “Mbi të gjitha kontrata është mbyllur me procesverbal pranimit nga ana juaj, pa asnjë rezervë mbi veprimtarinë e kompanisë, por me konsideratë të lartë”.

Pas 2 viteve me shkresën nr. 133/4, datë 13.09.2022 “Kthim Përgjigje” nga dërgimi i dokumentacionit nga Ministria e Shëndetësisë, Avokatura e Shtetit është kontradiktore pasi nga njëra anë dërgon draft paditë, nga ana tjetër me emailin e datës 15.09.2022 shprehen:

“3. Duke pasur parasysh se marrëdhënia midis palëve në rastin konkret është kontradiktore dhe me qëllim mbrojtjen sa më efektive të argumenteve ligjorë të MSHMS –së, vlerësojmë se raporti i KLSH-së nuk mund të shërbejë në vetvete si shkak juridik padie.

4. Sugjerojmë një analizë të plotë të dispozitave kontraktore, provave dhe fakteve që ndihmojnë për të mbështetur pretendimet.”

I njëjti argument vlen edhe për Avokaturën e Shtetit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës nr. 1179/16 datë 30.03.2016 lidhur ndërmjet operatorit ekonomik I. S.p.a dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Lotin I, LOTIN III, LOTIN V dhe LOTIN VI, për aparatura mjekësore të ndryshme me një vlerë kontrate prej 2,313,621.95 euro, u konstatuan mangësi në lidhje me zbatimin e afateve të lëvrimit të mallrave të kontratës konkretisht:

- Nga auditimi afateve të lëvrimit të mallit referuar nenit 4 të kontratës pika 7) **Dizenjo dhe kronogram** për paisjet e furnizuara me faturën komerciale nr. 201705000008 datë 24.02.2017 sipas këtij dokumenti afati maksimal për furnizim është 60 ditë, nga datë 13.01.2017 operatori ekonomik sipas Kronogramës ka 60 ditë kohë maksimale për dërgimin e mallit në Shqipëri, praktikant doganore së bashku me transportin deri në SUT.

Sipas dokumentacionit në praktiken e pagesës, malli ka mbërritur dhe ka dalë nga dogana Shqiptare më 22.03.2017 pra 69 ditë pas datës 13.01.2017 ose 9 ditë më vonë se afati maksimal i përcaktuar nga në kronogram kjo vonesë ka sjellë një penaltet të pa llogaritur dhe mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 642,652.43 Euro x 0.20% x 9 ditë = 11,567.7 Euro e cila përbën dëm ekonomik** dhe duhet kërkuar operatorit ekonomik I. s.p.a.

- Sipas dokumentacionit shoqërues të pagesës mallrat janë furnizuar ditën e 88 ose me 28 ditë vonesë kanë sjellë një penaltet të pa llogaritur dhe mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 530,781.36 Euro x 0.20% x 28 ditë = 29,723.7 Euro.**

- Sipas dokumentacionit shoqërues të pagesës mallrat janë furnizuar ditën e 96 ose me 36 ditë vonesë kanë sjellë një penaltet të pa llogaritur dhe mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 217,423.14 Euro x 0.20% x 36 ditë = 15,654.4 Euro.**

Në zbatim të kontratës mes palëve pika 7 “Afati i dorëzimit dhe penaltetet në vonesa” si dhe kushteve special të kontratës Aneksi III parashikuar në nenin 21 “Vonesa në ekzekutim-Penaltetet” parashikohet se:

;2Në rast vonese në dorëzimin e mallit, duke respektuar afatet e nënshkruara, operatori i paguan autoriteti kontraktorë një penaltet vonese në vlerën (0.20%) të vlerës së pajisjeve të pa furnizuara në kohë për cdo ditë vonesë deri sa të furnizohen.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 76-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **56,945.8 Euro** ndaj kontraktorit I. s.p.a si penaltete të pa llogaritura.

Menjëherë

Koment: Me shkresën nr. 2934 datë 15.07.2020 Ministria e Shëndetësisë i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit asistencë teknike lidhur me hartimin e kërkesë padisë dhe përgatitjen e mbrojtjes për MSHMC për të ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës referuar rekomandimit të KLSH. Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2863/3 prot datë 25.8.2020 ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë informacion ligjore në lidhje me dëmin e

nxjerrënga KLSH për të vazhduar më tej me procesin. Deri në fund të peirudhë auditimit nuk u vendosën dokumentacion shtesë në dispozicion. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Është vijuar edhe me njoftimin e operatorëve por pas përfundimit të kontratës. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer, me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Pas 11 muajve nga dërgimi i raportit përfundimtar (nr. 1417/8 datë 09.08.2019) MSHMS ka kërkuar ekzekutim vullnetar kontraktorëve italian pas përfundimit të kontratave respektive dhe likuidimit të plotë (likuidimi i fundit 02.07.2020) ka kërkuar likuidim formalisht likuidim vullnetar në 07.07.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm G. P. (I. Spa me shkresën nr. 2934/3, datë 07.07.2020). Formalitet i cili provohet edhe nga kontraktorët Italian, konkretisht shprehen “*Mbi të gjitha kontrata është mbyllur me procesverbal pranimi nga ana juaj, pa asnjë rezervë mbi veprimtarinë e kompanisë, por me konsideratë të lartë*”.

Pas 2 viteve me shkresën nr. 133/4, datë 13.09.2022 “Kthim Përgjigje” nga dërgimi i dokumentacionit nga Ministria e Shëndetësisë, Avokatura e Shtetit është kontradiktore pasi nga njëra anë dërgon draft paditë, nga ana tjetër me emailin e datës 15.09.2022 shprehen:

“3. Duke pasur parasysh se marrëdhënia midis palëve në rastin konkret është kontradiktore dhe me qëllim mbrojtjen sa më efektive të argumenteve ligjorë të MSHMS –së, vlerësojmë se raporti i KLSH-së nuk mund të shërbejë në vetvete si shkak juridik padie.

4. Sugjerojmë një analizë të plotë të dispozitave kontraktore, provave dhe fakteve që ndihmojnë për të mbështetur pretendimet.”

I njëjti argument vlen edhe për Avokaturën e Shtetit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratën nr. 1179/13 datë 25.03.2016 lidhur ndërmjet operatorit ekonomik C. M. S. Spa (sot A.) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Lotin IV, për pajisje radiologjike, nisur nga instalimi përdorimi eficient dhe mirë administrimi apo mbarëvajtja e pajisjeve për këtë kontratë.

Duke marrë parasysh situatën fillestare të krijuar edhe nga mos marrja në dorëzim të pajisjeve nga ana e MSHMS nga e cila ngarkohet me përgjegjësi njësi zbatuese e projektit për vonesat e shkaktuara përsëri është e pa u justifikuar vonesa në ofrimin e shërbimit të riparimit për 6 muaj rresht të këtyre pajisjeve. Gjatë verifikimit të datës 26 Shkurt 2019 pajisjet e konstatuar me defekt ishin riparuar dhe nga ana e stafit na u bë me dije se janë riparuar më 21.02.2019.

Në zbatim të nenit 21 “Vonesa në ekzekutim të kontratës dhe penalitetet” në paragrafin 3 shprehet se: *Për çdo ditë vonesë në kryerjen e ndërhyrjeve në asistencë dhe mirëmbajtje të artikujve dhe aparatave të furnizuara, në respektim të cka është deklaruar në ofertë, ofertuesi duhet t'i paguaj një penalitet deri në 1,000 euro në ditë.*

-Në respektim të këtij neni nga njësi e projektit, duhet të llogariten penalitet e krijuara nga vonesat në ofrimin e shërbimit **ndaj kompanisë italiane A., si dhe përfaqësuesit të saj për ofrimin e shërbimeve pas shitjes A. T.**

Penaliteti shkon deri në 1000 euro/ditë sipas kontratës, në këtë rast duke qenë se kontrata bazë është në vlerën prej 636,750 euro dhe nga këto vetëm një pjesë të paisjeve kanë paraqitur probleme në vlerën 214,000 euro, ose 33% e kontratës, atëhere dhe vlera për përlllogaritjen e penalitetit do merret 33% e 1000 eurove/dita ose 330 Euro në ditë. Gjithashtu në respektim të nenit 32 detyrimet dhe garancitë pika 32.3 ndër të tjera citon: Kompania merr masa me shpenzimet e saj për të riparuar defektet dhe problemet në kohën më të shpejt të mundshme, për të minimizuar në maksimum pakënaqësitë për pacientët dhe specialistët e SUT, **por maksimalisht jo më tepër se 30 ditë nga njoftimi i defektit.**

-Nga mos llogaritja e penalteteve në ofrimin e shërbimeve pas shitjes në riparime mirëmbajtje dhe asistencë teknike për 6 muaj rresht, vënia në vështirësi të stafit të SUT në ofrimin e shërbimeve dhe rritjen e pakënaqësisë ndaj pacientëve, këto vonesa kanë sjellë një penaltet të pa llogaritur dhe pa mbajtur ndaj operatorit ekonomik në vlerën **prej 179 ditë x 330 Euro dita = 59,070 Euro dëm ekonomik i cili i duhet mbajtur operatorit ekonomik A. Srl.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 99-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandime: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të analizojë situatën dhe të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **59,070 Euro** ndaj kontraktorit **A. Srl.** si penaltete të pa llogaritura.

Menjëherë

Koment: Me shkresën nr. 2934 datë 15.07.2020 Ministria e Shëndetësisë i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit asistencë teknike lidhur me hartimin e kërkesë padisë dhe përgatitjen e mbrojtjes për MSHMC për të ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës referuar rekomandimit të KLSH. Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2863/3 prot datë 25.8.2020 ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë informacion ligjore në lidhje me dëmin e nxjerrënga KLSH për të vazhduar më tej me procesin. Deri në fund të peirudhë auditimit nuk u vendosën dokumentacion shtesë në dispozicion. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Është vijuar edhe me njoftimin e operatorëve por pas përfundimit të kontratës. Pas vijimit të komunikimit shkresor për dërgimin e dokumentave të përkthyer, me shkresën nr. 2934/17, datë 24.11.2020 “Dërgim dokumentacioni” MSHMS ka përcjell dokumentat e përkthyer pranë Avokaturës së Shtetit. Pas 11 muajve nga dërgimi i raportit përfundimtar (nr. 1417/8 datë 09.08.2019) MSHMS ka kërkuar ekzekutim vullnetar kontraktorëve italian pas përfundimit të kontratave respektive dhe likuidimit të plotë (likuidimi i fundit 02.07.2020) ka kërkuar likuidim formalisht likuidim vullnetar në 07.07.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm G. P. (Assing Srl shkresa nr. 2934/2, datë 07.07.2020). Formalitet i cili provohet edhe nga kontraktorët Italian, konkretisht shprehen “*Mbi të gjitha kontrata është mbyllur me procesverbal pranimi nga ana juaj, pa asnjë rezervë mbi veprimtarinë e kompanisë, por me konsideratë të lartë*”.

Pas 2 viteve me shkresën nr. 133/4, datë 13.09.2022 “Kthim Përgjigje” nga dërgimi i dokumentacionit nga Ministria e Shëndetësisë, Avokatura e Shtetit është kontradiktore pasi nga njëra anë dërgon draft paditë, nga ana tjetër me emailin e datës 15.09.2022 shprehen:

“3. Duke pasur parasysh se marrëdhënia midis palëve në rastin konkret është kontradiktore dhe me qëllim mbrojtjen sa më efektive të argumenteve ligjorë të MSHMS –së, vlerësojmë se raporti i KLSH-së nuk mund të shërbejë në vetvete si shkak juridik padie.

4. Sugjerojmë një analizë të plotë të dispozitave kontraktore, provave dhe fakteve që ndihmojnë për të mbështetur pretendimet.”

I njëjti argument vlen edhe për Avokaturën e Shtetit.

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, mbështetur në nenin 37 të tij si dhe Kontratës Individuale të Punës, i rekomandojmë Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara për implementimin e projektit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Shqiptare”, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe

të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore për personat që gjenden, për arsye se stafi i angazhuar tek PIU i projektit është i angazhuar në kryerjen e detyrave të tjera funksionale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Spitalin Universitar të Traumës.

Rekomandimi nuk është realizuar

Nuk është filluar procedim disiplinor për strukturat përgjegjëse të projektit.

Për mos zbatimin e rekomandimeve mban përgjegjësi ish Sekretari i Përgjithshëm zj. G. P.

2.2 Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre.

Në zbatim të pikës 2¹ të Programit të Auditimit nr. 134/1, datë 08/02/2024 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Marrëveshja qeveritare dhe ajo financiare të ratifikuara me ligjin nr. 9617, datë 16.10.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me objekt realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, si dhe me ligjin nr.9656, datë 11.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SPA për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”;

2. Ndryshimet e këtyre marrëveshjeve bazë me ligjin nr. 153, datë 21.12.2015 “Për ratifikimin e dokumenteve ndryshuese me shkëmbim notash, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me objekt realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës””, si dhe me ligjin nr. 84, datë 4.05.2017 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SPA për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”;

3. Dokumentet e prokurimeve;

4. Shkresa të tjera.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në Kushtetutën e Shqipërisë, ligjin nr. 9617, datë 16.10.2006, si dhe në ligjin nr.9656, datë 11.12.2006 përsa i përket zhvillimit të procedurave të prokurimit nga një institucion (Ministria e Shëndetësisë) i cili bazuar në marrëveshjet në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave, nuk e kishte një kompetencë të tillë, si dhe përcaktimi në dokumentet e që përcaktojnë kriteret dhe procedurën e prokurimit të një përqindje më të lartë të kredisë së ndihmës për kosto lokale dhe/ose në vendet e OECD-së, duke zbatuar në këtë mënyrë pa hyrë ende në fuqi parashikimet e ndryshimeve të marrëveshjes në kundërshtim me Ligjin nr. 9617, datë 16.10.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me objekt realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave të prokurimit në nenet: 4 pika b, paragrafi i parë; 5, pika c, paragrafi 4,5; 6; 14; Aneksi 3, Seksioni I pika 1,3; Aneksi 3, Seksioni II pika 1,2,4 dhe Ligjin nr.9656, datë 11.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së

¹ Trajtuar edhe në Raportin e Auditimit të projektit deri në datë 31.12.2018

Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SPA për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave të prokurimit, në nenin 1 të tij.

Nga auditimi i zhvilluar, konstatohet se Ministria e Mbrojtjes dhe ajo e Shëndetësisë kanë filluar zbatimin e ndryshimeve të marrëveshjes qeveritare ende pa u ratifikuar nga Kuvendi dhe hyrë në fuqi këto ndryshime, duke bërë që marrëveshja të implementohet nga një institucion, Ministria e Shëndetësisë, që nuk e kishte një kompetencë të tillë sipas të drejtës në fuqi.

Më konkretisht, nga auditimi rezultoi që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, më datë 16.10.2006, me ligjin nr. 9617, ratifikoi marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me objekt realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”. Kjo marrëveshje u botua në fletoren zyrtare nr.118, datë 17.11.2006.

Ligji nr.9617, datë 16.10.2006 për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të Përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” parashikon se qeveria italiane merr përsipër të financojë një ndërhyrje për fuqizimin dhe përmirësimin e funksionalitetit të Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës duke përcaktuar për këtë qëllim një kredi ndihmëse në vlerën e 5,000,000.00 euro-ve për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në program dhe një donacion prej 150 000,00 euro-sh për veprimtaritë e kontrollit dhe asistencës teknike si gjatë shpalljes së tenderave, ashtu edhe gjatë zbatimit të veprimtarive të programit. Periudha e kthimit të kredisë parashikohet 19 vjet, periudha e faljes (për kthimin e kredisë) parashikohet 8 vjet dhe përqindja e interesit vjetor 0.20%.

Objektivi i përgjithshëm i Programit është përmirësimi i gjendjes së shëndetit të popullsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë të popullsisë së prekur nga trauma.

Ndërsa objektivat specifike kërkojnë të bëjnë më efikente e më efikase veprimtarinë terapeutike të Qendrës Traumatologjike Kombëtare, duke rritur në këtë mënyrë ndikimin mbi shëndetin e popullsisë dhe njëkohësisht për të përmirësuar prognozën *quod valitudinem* të pacientëve politraumatikë me pasojë uljen e paaftësisë të përkohshme dhe të përhershme dhe të kostove që lidhen me to. Programi synon të arrijë pajisjen e Qendrës Traumatologjike Kombëtare me aparataturat e duhura mjekësore dhe ta bëjë atë të përshtatshme për rolin që ajo ka si pikë referimi kombëtare për pacientët e traumatizuar. Zbatimi i Programit sjell furnizimin me pajisje mjekësore dhe orendi, një shërbim asistence teknike, mirëmbajtje dhe trajnimi të specializuar, përpos garancisë së zakonshme të pajisjeve, një sasi të përshtatshme materialesh konsumi për Qendrën Traumatologjike Kombëtare.

Për palën italiane, përveç Ministrisë së Punëve të Jashtme (Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim) dhe Ambasadës italiane në Tiranë, institucion tjetër i përfshirë parashikohej dhe Artigiancassa S.P.A., e cila sipas udhëzimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Ekonomisë Italiane parashikohej të lidhte me Ministrinë e Financave Shqiptare një marrëveshje financiare që do të rregullonte përdorimin e fondeve të kredisë ndihmëse. Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje financiare, Artigiancassa S.P.A. do të kujdesej për lidhjen e kontratave të veçanta për lëvrimin e të mirave, shërbimeve dhe punimeve, përmes të cilave do të realizohen veprimtaritë e parashikuara në Program, si dhe do të kujdesej gjithashtu për të siguruar pagesën e shumave të kontratave në favor të organizmave realizues. Ndërsa për palën Shqiptare marrëveshja parashikon se institucionet e përfshira për realizimin e këtij program janë Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave. E para do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë strukturat e tjera kompetente shqiptare (në veçanti Ministrinë e Shëndetësisë) dhe do të kujdesej të

bashkërendojë funksionet me karakter teknik dhe drejtues të nevojshme për realizimin e Programit, ndërsa e dyta do të lidhë Marrëveshjen financiare me Artigiancassa S.P.A. dhe do të kujdeset për kontaktet operative me këtë të fundit.

Lidhur me përcaktimin e zbatuesve të veprimtarive të programit, marrëveshja parashikon përzgjedhjen e tyre përmes kryerjes së tenderave të rregulluar nga dispozita që përmban Manuali i Procedurave (përftuar nga Komisioni Evropian më 23 dhjetor 2002), në lidhje me "Prokurime shërbimesh, furnizimesh dhe punimesh në kuadrin e bashkëpunimit të Komunitetit Evropian me vendet e treta", si dhe nga sa është saktësuar në aneksin 2 të marrëveshjes në fjalë. Përveç të tjerash, Aneksi 2 i marrëveshjes parashikon kryerjen e tenderave ku mund të marrin pjesë vetëm shoqëri italiane dhe përqindja e kredisë së ndihmës që mund të përdoret për kostot lokale dhe/ose në vendet në zhvillim nuk mund të jetë më e lartë se 40% e vetë kredisë. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit për përzgjedhjen e fituesve (punime dhe supervision punimesh), bazuar në parashikimet e Aneksit 3 të marrëveshjes duhet të kryhej nga Ministria e Mbrojtjes dhe t'i përcillej Ambasadës Italiane në Tiranë me kërkesën për të botuar shpalljen e tenderave në gazetën italiane. Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë (Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim) parashikohet në marrëveshje të kryente kontrollin e përputhshmërisë së dokumentacionit të tenderit me parashikimet e marrëveshjes në fjalë. Ndërsa shqyrtimi i ofertave të paraqitura për çdo tender do të kryhet nga një komision vlerësimi i ngritur enkas nga Ministria e Mbrojtjes. Por, për çdo tender Ministria e Mbrojtjes duhet t'i përcillte Ambasadës Italiane në Tiranë dokumentacionin që përmban aktet e komisionit, së bashku me kontratën që duhet të lidhej, duke kërkuar të jepet miratimi për lidhjen e saj. Ky dokumentacion do të përcillet nga Ambasada pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë (Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim) me komentet e rastit. Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë (Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim) ka pasur të parashikuar kompetencën për të kontrolluar kryesisht përputhjen ligjore e teknike të vlerësimeve të kryera me procedurat e kriteret/parametrat e parashikuar në pjesën e posaçme të tenderit, dhe vetëm pasi të përfundonte verifikimet, Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë (Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim) do të njoftonte Ambasadën Italiane në Tiranë për rezultatin e tyre.

Vetëm në rast se verifikimi do të kishte rezultat pozitiv (pa asnjë pengesë), Ministria e Mbrojtjes do të procedonte me lidhjen e kontratave me shoqëritë e shpallura fituese.

Marrëveshja e ratifikuar parashikon në mënyrë specifike edhe elementët përbërës të programit dhe shumat e planifikuara për t'u shpenzuar lidhur me secilin prej tyre.

Pas ratifikimit me ligjin nr. 9617 datë 16.10.2006 të "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të Përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës", Kuvendi miratoi një tjetër marrëveshje lidhur me programin "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës". Kjo marrëveshje u miratua me ligjin nr. 9656, datë 11.12.2006 Për ratifikimin e "Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SPA për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

Me Vendimin nr. 892, datë 24.12.2012 "Për ndryshimin e emërimit të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar në "Spitali Universitar i Traumës" dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të tij nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë, si dhe për një ndryshim në Vendimin Nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", Këshilli i Ministrave vendosi ndryshimin e emërimit të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar në "Spitali Universitar i Traumës" dhe kalimin e

përgjegjësisë së administrimit të tij nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë. Bazuar në këtë ndryshim të përgjegjësisë së administrimit me Notën Verbale të datës 20.05.2014, Ambasada e Tiranës komunikon pranimin e ndryshimit të përfaqësimit të shtetit shqiptar në marrëveshjen qeveritare të ratifikuar me ligjin nr.9617, datë 16.10.2006, nga Ministria e Shëndetësisë dhe jo më nga Ministria e Mbrojtjes.

Muaj më pas, me shkresën nr. prot. 4081/1, datë 15.12.2014, drejtuar Ambasadorit të Italisë në Tiranë si dhe Drejtorit të Kooperacionit Italian, Ministri i Shëndetësisë kërkon ndryshimin e aneksit 2 “Prokurim shërbimesh, furnizimesh dhe punimesh” të marrëveshjes qeveritare të miratuar me ligjin nr. 9617, datë 16.10.2006. Më konkretisht, Ministri i Shëndetësisë kërkon ndryshimin e parashikimit “*“Përqindja e kredisë së ndihmës që mund të përdoret për kostot lokale dhe/ose në vendet në zhvillim nuk mund të jetë më e lartë se 40% e vetë kredisë”*”, me arsyetimin se “*është vërtetuar se për shkak të karakteristikave aktuale të tregut italian, për sigurimin e pajisjeve biomjekësore, përqindja e pajisjeve të origjinës italiane, mesatarisht nuk e kalon 40% të totalit të specifikuar*”, si dhe “*për më tepër, për të siguruar cilësinë e duhur të pajisjeve dhe konkurrencën e ofertave, konsiderohet e përshtatshme që tregu i synuar të jetë ai vendeve të OECD-së, sesa ai i vendeve në zhvillim, siç përmendet në Marrëveshje.*”

Me Notën Verbale të datës 21.05.2015, nr. Prot.2528 pala italiane pranon këtë ndryshim të marrëveshjes. Këto ndryshime të marrëveshjes, ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 21.12.2015 dhe botohen në fletoren zyrtare nr.246, datë 21.01.2016.

Vetë nota verbale e datës 21.05.2015, nr. Prot.2528, si dhe më pas ligji që ratifikon ndryshimin e marrëveshjes ndërkombëtare parashikojnë se pasi qeveria italiane përmes kësaj note verbale shprehu vullnetin e saj për ndryshimin e marrëveshjes si më sipër, nota verbale e datës 21.05.2015, si dhe ajo Nota Verbale e përgjigjes me të njëjtin standard do të hyjnë në fuqi pasi Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë të ketë rënë dakord me propozimet e mësipërme dhe pasi të jetë marrë njoftimi i dytë, nga dy njoftimet e parashikuara me të cilat palët nënshkruese do të komunikojnë zyrtarisht përfundimin e procedurave kombëtare të ratifikimit të parashikuara.

Duke u bazuar në sa më sipër, pas marrjes së Notës Verbale nga pala italiane, Ministria e Mbrojtjes dhe ajo e Shëndetësisë, si dhe nëpunësit e përfshirë në këto procedura prokurimi, për të filluar zbatimin e ndryshimeve të marrëveshjes qeveritare, jo vetëm që duhet të kishin marrë miratimin e Këshillit të Ministrave për këto ndryshime, por duhet edhe të prisnin derisa këto ndryshime të ratifikoheshin me ligj nga Kuvendi. Madje edhe pasi këto ndryshime të ishin ratifikuar me ligj nga Kuvendi dhe botuar në fletoren tonë zyrtare siç parashikon Kushtetuta, ende nuk mund të zbatoheshin, për sa kohë nota verbale e palës italiane e datës 21.05.2015, e ratifikuar me ligj, parashikon se ndryshimet do të hyjnë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet e parashikuara me të cilat palët nënshkruese do të komunikojnë zyrtarisht përfundimin e procedurave kombëtare të ratifikimit të parashikuara.

Ende pa hyrë në fuqi këto ndryshime, Ministria e Shëndetësisë, dhe jo Ministria e Mbrojtjes siç parashikonte marrëveshja në fuqi, publikon, më datë 29.07.2015 njoftimin për zhvillimin e procedurave të prokurimit me objekt “Fuqizimin e Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

Përfundimisht, nga përmbajtja e ligjit ratifikues evidentohet se marrëveshja ka pësuar këto ndryshime:

1.Roli i kontraktuesit të marrëveshjes dy palëshe të Programit për palën shqiptare nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë. Ky ndryshim erdhi si pasojë e kalimit të përgjegjësisë së administrimit të Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë;

2.Parashikimi në Aneksin 2 të marrëveshjes ndërqeveritare se “*Përqindja e kredisë së ndihmës që mund të përdoret për kostot lokale dhe/ose në vendet në zhvillim nuk mund të jetë më e lartë*”

se 40% e vetë kredisë” u ndryshua duke u rritur në 60%, duke u zëvendësuar në mënyrë eksplicite me parashikimin “Përqindja e kredisë së ndihmës të përdorur për kostot lokale dhe/ose vendeve OCSE, nuk mund të kaloj 60 % të kredisë”.

3. Afati i marrëveshjes ndërqeveritare, i parashikuar në nenin 15, pikën “b” të saj si një “marrëveshje me kohëzgjatje trevjeçare dhe që do të ripërtërihet heshturazi për periudha të mëtejshme me të njëjtën kohëzgjatje” u zgjat në mënyrë të shprehur përmes parashikimit “shtyrje e afatit të marrëveshjes deri më 31 dhjetor 2015”.

4. Emërtimi “Ministria e Punëve të Jashtme” (të Italisë) u zëvendësua me “Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar”. Shkurtimi i saj nga “MAE” (anakronim i “Ministero degli Affari Esteri) zëvendësohet me “MAECI” (anakronim i “Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale”). Konstatohet se një ndryshim i tillë është diktuar nga nevoja për të reflektuar emërtimin institucional të kësaj Ministrie për shkak të ndryshimeve të pësura në emërtimin e saj me Ligjin e 11 gushtit 2014, n. 125 “Rregullorja e përgjithshme për bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillim”².

Pas ndryshimit të marrëveshjes ndërqeveritare në 2015, ndryshime pëson edhe marrëveshja tjetër, ajo financiare mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, përmes ligjit nr. 84, datë 4.05.2017, botuar në fletoren zyrtare nr.116, datë 23.05.2017.

Konstatohet se ndryshimet e marrëveshjes financiare, përmes ligjit nr. 84, datë 4.05.2017 kanë një karakter formal dhe josubstancial, duke qenë se janë pasqyrim i ndryshimeve të bëra në marrëveshjen ndërqeveritare me ligjin nr. 153, datë 21.12.2015. Më konkretisht këto ndryshime konsistojnë në:

1. Shtimin e përkufizimeve lidhur me anakronimet “MSH”, “MPJBN”, “Cassa depositi e prestiti S.p.A” dhe zëvendësimin në të gjithë marrëveshjen financiare të anakronimeve “MM” me “MSH”, “MPJ/DPBZ” me “MPJBN/DPBZ”.

2. Zëvendësimin në të gjithë marrëveshjen financiare të “Artigiancassa me “Cassa depositi e prestiti S.p.A”.

3. Në të njëjtën linjë me ndryshimin e marrëveshjes ndërqeveritare me ligjin nr. 153, datë 21.12.2015 edhe këtu pasqyrohet rritja e përqindjes së huasë së butë e cila mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe të importimit të mallrave dhe shërbimeve me origjinë prej vendeve në zhvillim. Si pasojë e këtij ndryshim, “një shumë maksimale prej 60 % (gjashtëdhjetë për qind) e shumës së lidhur me huanë e butë mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe importet të mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga vendet në zhvillim”, nga 40% që ishte përcaktuar kjo shumë në marrëveshjen bazë financiare dhe atë ndërqeveritare. Si konkluzion deri në përfundim të projektit rezulton se marrëveshja e financimit është realizuar si më poshtë:

Tabela1: Financimi sipas donatorëve

Në euro/lekë

Burimi	Fondet sipas Marrëveshjeve	Monedha	Financuar në fakt	Monedha	% e financimit plan-fakt
Qeveria Shqiptare	1,000,000	Euro	133,916,186	lekë	
Qeveria Italiane	5,000,000	Euro	4,996,500	euro	99.93
Qeveria Italiane donacion	150,000	Euro	-	euro	
TOTALI	6,000,000	Euro			

Burimi i të dhënave: Ministria e Shëndetësisë

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Janë zbatuar, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë, ende pa u

² Legge dell’11 agosto 2014, n. 125 “Disciplina generale sulla cooperazione internazionale per lo sviluppo”, publikuar në fletoren zyrtare nr.199, datë 28 gusht 2014.

ratifikuar nga Kuvendi dhe pa hyrë në fuqi, ndryshimet e marrëveshjes ndërkombëtare nr.9617, datë 16.10.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me objekt realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

2. Nuk janë zbatuar parashikimet e marrëveshjes qeveritare dhe asaj financiare në fuqi lidhur me organin kompetent që duhet të siguronte zbatimin e detyrimeve të marrëveshjes lidhur me pjesën e zhvillimit të procedurës së prokurimeve, si dhe parashikimin në dokumentet e tenderit të përdorimit të një përqindje të më të lartë të kredisë së ndihmës për kosto lokale dhe/ose të vendeve të OECD (dhe jo nga vendet në zhvillim), si dhe parashikimet lidhur me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të marrëveshjes qeveritare.

Nga auditimi rezultuan shkelje të parashikimeve juridike lidhur me marrjen në dorëzim dhe arkivimin e dokumentacionit. Dokumentacioni i plotë i projektit: si: bërja efektive e marrëveshjeve, hartimi i nevojave, korresponcenca midis palëve të marrëveshjes, me ministrinë e financave, me bankën agjente në Shqipëri, procedura prokurimi, zbatimi kontatash, etj. nuk janë dorëzuar me fletë inventari të rregullt në arkivë në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar me Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 të KM për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

1. Ligjin nr. 9617, datë 16.10.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me objekt realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

2. Ligjin nr.9656, datë 11.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SPA për financimin e programit ‘Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës’”.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi menaxhmentin dhe strukturat e përfshirë në këtë proces.

2.3 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit.

Në zbatim të pikës 3³ të Programit të Auditimit nr. 134/1, datë 08/02/2024 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Marrëveshja, Ligji nr. 9617, datë 16.10.2006 për ratifikimin e “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës" dhe ndryshimet përkatëse me Ligjin Nr. 153/2015 për ratifikimin e dokumenteve ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes, dhe Qeverisë së Republikës së Italisë,

³ Trajtuar edhe në Raportin e Auditimit të projektit deri në datë 31.12.2018

përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e Programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, nënshkruar më 12.7.2006

2) Ligj Nr. 9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e “Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa Spa, për financimin e Programit ‘Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës’”.

3) Kontratat e lidhura ndërmjet firmave fituese.

4) Dokumentet e procesit të marrjes në dorëzim të pajisjeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Programi përmban dy objektiva bazë (Objektivat e Programit) të cilët janë:

1. Objektivi i përgjithshëm i Programit është i vetëm dhe qëndron në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të popullsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë të popullsisë së prekur nga trauma, si dhe

2. Objektivat specifik të cilët kërkojnë të bëjnë më eficientë e më efikasë veprimtarinë terapeutike të Qendrës Traumatologjike Kombëtare, duke rritur në këtë mënyrë ndikimin mbi shëndetin e popullsisë dhe njëkohësisht për të përmirësuar prognozën quod valitudinem të pacientëve politraumatikë me pasojë uljen e paaftësive të përkohshme dhe të përhershme dhe të kostove që lidhen me to.

Programi synon të arrijë pajisjen e Qendrës Traumatologjike Kombëtare me aparaturat e duhura mjekësore dhe ta bëjë atë të përshtatshme për rolin që ajo ka si pikë referimi kombëtare për pacientët e traumatizuar.

Zbatimi i Programit konsiston në furnizimin me:

- pajisje mjekësore dhe orendi;
- një shërbim asistence teknike, mirëmbajtje dhe trajnimi të specializuar;
- përpos garancisë së zakonshme të pajisjeve;
- një sasi të përshtatshme materialesh konsumi për QTK.

Nga auditimi rezultoi se ajo çka synohet të arrihet me anë të këtij programi, pra pajisja me aparatura mjekësore duke e bërë atë të përshtatshme si pikë referimi për pacientët e traumatizuar është realizuar edhe pse jo në kohë (*me mbi 16 vjet vonesë nga marrëveshja fillestare*). Mbi realizimin e objektivave specifik grupi i auditimit refuzon të japi opinion pasi nuk është hartuar raporti i vlerësimit përfundimtar nga spitali i traumës si përfituesi direkt i kredisë së ndihmës, në zbatim të nenit 15, pika 5 e të Ligjit nr. 9617, datë 16.10.2006, si dhe nuk kemi indikatorë të matshëm mbi ndikimin në shëndetin e pacientëve politraumatik të cilët janë trajtuar mbas zbatimit të projektit, në mënyrë që të mund ti krahasonim ato.

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit

Për palën italiane, për realizimin e projektit është MPJ/DPKZH (Ministria e Punëve të Jashtme/Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim për Zhvillim) e cila do të sigurojë livrimin e burimeve financiare me kredi, sipas mënyrave të parashikuara nga kuadri ligjor italian në fuqi. MPJ/DPKZH, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes (MM) Shqiptare ndryshuar në marrëveshjet e mëvonshme në (MSH), do të kenë gjithashtu për detyrë të kontrollojnë ecurinë e Programit dhe aftësinë e tij për të arritur rezultatet e treguara në nenin 3 të marrëveshjes. MPJ/DPKZH do të veprojnë përmes zyrave kompetente për kryerjen e detyrave të veta. Në veçanti, Zyra Teknike Qendrore e MPJ/DPKZH, do të garantojë të gjitha funksionet me karakter teknik në mbështetje të realizimit të Programit ndërsa për Palën Shqiptare, MM, e cila do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë strukturat e tjera kompetente shqiptare (në veçanti Ministrinë e Shëndetësisë) dhe do të kujdeset të bashkërendojë funksionet me karakter teknik dhe drejtues të nevojshme për implementimin e programit.

Nga auditimi u konstatua se vonesat në implementimin e programit kanë ardhur kryesisht nga pala shqiptare pasi nga fillimi i tij deri në vitin 2014 mbi projektin nuk rezultoi të jetë zhvilluar asnjë aktivitet për të vënë në lëvizje strukturat kompetente të cilat do të siguronin zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja si dhe as nuk rezultoi të jetë nxitur bashkëpunimi me institucionet e huaja në mbështetje të programit. Pra, mund të themi se ky projekt për një periudhë prej 9 vitesh nuk është implementuar.

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e Programit janë:

1. Kredia ndihmëse prej 5,000,000 euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në Program.

2. Donacion prej 150,000 euro për veprimtaritë e kontrollit dhe asistencës teknike si gjatë shpalljes së tenderëve, ashtu dhe gjatë zbatimit të veprimtarive të Programit.

Pjesa e donacionit, prej 0.15 milion Euro që ka për qëllim veprimtarinë e asistencës teknike dhe të kontrollit në ministrinë përfituese, do të administrohet drejtpërsëdrejti nga DPKZH, siç sqaruar më mirë në marrëveshjen e programit. Nga auditimi rezultoi se për këtë pjesë nuk disponohet asnjë dokumentacion si dhe personat të cilët janë aktualisht në ministri përgjegjës për menaxhimin e projektit, nuk kanë dijeni se si dhe nga kush janë menaxhuar fondet e pjesës së parë të donacionit, pasi këta janë bërë pjesë në një fazë shumë të vonshme të tij. Gjithashtu në ministri nuk ka asnjë dokumentacion si rezultat i pjesës së parë të hartimit të nevojave të spitalit të traumës dhe asistencës teknike për ndihmën pasi furnizimi me aparataturat mjekësore bazohet në rilevimet e zhvilluara gjatë fazës së hartimit dhe në "Master Plan of Emergency Department and the Operation Unit of National Trauma Center".

Ndërrhyrja e financuar me kredi ndihme do të duhet të kishte një kohëzgjatje të përgjithshme prej 24 muajsh. Gjatë periudhës së parë gjashtëmujore (viti 2006) në bazë të marrëveshjes së programit, duhet të kryhej puna përgatitore për tenderin, që duhej financuar nëpërmjet donacionit.

Programi parashikon pajisjen e plotë të Qendrës Traumatologjike Kombëtare me pajisjet e duhura mjekësore dhe orenditë nëpërmjet shumës së përgjithshme të kredisë prej 5 milionë euro e cila përfshin në vetvete furnizimin me:

- aparatura biomjekësore dhe orendi (4.6 milionë euro);
- asistencë, mirëmbajtje dhe trajnim (0.22 milionë euro);
- materiale konsumi (0.18 milionë euro).

Nga auditimi u konstatua se nuk ka një ndarje të qartë në lidhje me shumatat që janë akorduar për secilin nga komponentët e sipërpërmendur, pasi nuk është hartuar raporti përfundimtar i vlerësimit të projektit dhe nuk mund të evidentohet ndarja e këtyre zërave sipas kontratave të lidhura, pasi në një prej kontratave të lidhura mund të jene përfshirë 2 ose më shumë lote të cilat në vetvete përfshinë pajisje që mund të përkasin komponentëve të ndryshëm. Edhe pse implementimi dhe marrja në dorëzim e pajisjeve ka përfunduar nuk mund të shprehemi arritjen e këtij objekti.

Programi përbëhet nga:

A. Furnizimi i aparataturave biomjekësore dhe orendive

Kooperacioni italian financon, me kredi ndihmëse, aparataturat biomjekësore dhe orenditë e nevojshme për ndihmën e shpejtë, bllokun operator, reanimacionin, shtrimet sipas specialiteteve të ndryshme kirurgjikale dhe morgun.

Furnizimi do të përfshijë edhe një shërbim diagnostikimi me imazh që do të përbëhet nga një njësi radiologjie dhe një njësi për rezonancën magnetike. Duke pasur parasysh specifikën e shërbimit të ofruar nga Qendra Traumatologjike Kombëtare, vendosja e shërbimit të rezonancës magnetike në këtë Qendër në fazën e nënshkrimit të marrëveshjes është konsideruar shumë e rëndësishme për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit terapeutik të Qendrës, si dhe për rritjen e treguesit të mbulimit në nivel kombëtar të këtij shërbimi diagnostikues.

Njësitë që do të pajisen me financimin italian do të jenë:

- Ndhimja e shpejtë, furnizimi i së cilës do të konsistonte në pajisjen e një mjedisi për pranimin dhe ndjekjen e pacientëve, dy salla operacioni për pranimin dhe ndjekjen e pacientëve, dy salla operacioni për trajtimin e pacientëve politraumatikë (sallat trauma), një sallë operacioni për ndërhyrje të kirurgjisë së përgjithshme, një laborator për analiza klinike të urgjencës, një sistem informacioni për menaxhimin e pranimeve dhe të gjitha mjediseve të shërbimit shtesë për funksionimin e rregullt të shërbimit të urgjencës.

-Blloku operator ku duhej të përbëhej nga pesë salla operacioni të pajisura sipas tipologjive të ndryshme të ndërhyrjeve kirurgjikale dhe me mjediset e nevojshme për funksionimin e rregullt të tij si: filtra, hapësira për përgatitjen e pacientëve, sterilizimin, nënsterilizimin dhe mjedisë shërbimi për stafin e sallës së operacionit. Sallat e operacionit që parashikohen të pajisen janë: një sallë për ndërhyrjet ortopedike, një sallë për ndërhyrjet neurokirurgjike dhe tri salla për ndërhyrjet në urologji, gastroenterologji, kirurgji vaskulare, gjinekologji, otorinolaringoiatri dhe okulistikë.

-Terapi intensive (reanimacion) do të organizohet në tre sektorë kryesorë: zona e terapisë intensive (8 shtretër, 1 prej të cilëve për pacientë të infektuar dhe 2 për pacientë me djegie), zona e terapisë subintensive (8 shtretër), dhoma e kontrollit.

-Diagnostikimi me imazh do të përbëhet nga një njësi radiologjike dhe një rezonancë magnetike. Shërbimi i radiologjisë do të përbëhet nga një aparaturë radiologjike fikse dhe nga një sistem për fluoroskopinë. Ky shërbim do të pajiset me të gjithë aksesorët dhe mjediset e nevojshme për funksionimin e tij. Rezonanca magnetike që mendohej të ofrohej do të ishte e llojit me "magnet fiks" për aplikime ortopedike dhe traumatologjike. Ky furnizim duhet të përfshijë të gjitha hollësitë e nevojshme për funksionimin e rregullt të implantit.

-Shttrimet do të pajiseshin me gjithë sa është e domosdoshme. Parashikohej të furnizoheshin shtretërit për shttrimet dhe orenditë më të nevojshme përkatëse për të gjithë 120 shtretërit në repartet e ndryshme.

-Salla e morgut parashikonte pajisjen e sallës për ruajtjen e kufomave, sallën për autopsinë dhe pajisjen e mjediseve ndihmëse, si ato të përgatitjes së mjekëve dhe sterilizimit.

Një zë shpenzimi është parashikuar për (a.7 Energji elektrike e vazhdueshme) për blerjen e aparaturave që janë në gjendje të sigurojnë vazhdimësinë e shërbimit të energjisë elektrike, sidomos për njësitë operative, funksionimi i të cilave është kritik për shëndetin e pacientit ose ruajtjen e aparaturave. Për këtë arsye parashikohej furnizimi i grupeve statike të rrymës së vazhdueshme (UPS), vendosja dhe përdorimi i të cilave do të përcaktohej gjatë hartimit të planit të përgjithshëm për pajisjet. Në mbështetje të këtyre grupeve do të shihej mundësia për të përfshirë furnizimin e një gjeneratori.

B. Furnizimi i një plani për asistencë dhe mirëmbajtje

Për të siguruar funksionimin e plotë të aparaturave biomjekësore, Programi duhet të ofrojë furnizimin me aparatura, përveç trajnimit specifik, por edhe një plan asistence e mirëmbajtje për një shërbim të plotë e të përgjithshëm, që bën të mundur përballimin e nevojave që mund të lindin në fazën e parë të vënies në punë të aparaturave biomjekësore. Ky plan asistence dhe mirëmbajtje do të konsistonte në ndërhyrje si për ndreqjen, ashtu dhe për parandalimin e problemeve. Ky plan asistence përfaqëson një element thelbësor për qëndrueshmërinë e ndërhyrjes pasi, nëse do të menaxhohej ashtu siç duhet dhe do të shoqërohej nga personel teknik lokal, do të ishte një mundësi e mirë për transferimin e njohurive. Kohëzgjatja e këtij plani asistence dhe mirëmbajtjeje duhet të jetë njëvjeçar. Mendohet se kjo është kohëzgjatja e përshtatshme për të nisur këtë transferim të nevojshëm të kompetencave.

C. Furnizim i materialeve të konsumit

Furnizimi i të mirave parashikonte një sasi të përshtatshme materialesh konsumi për aparaturat kryesore që shërbejnë për të kapërcyer fazën kritike të vënies në punë të njërive që do të pajiseshin.

Për gjithë sa trajtohet më sipër nga auditimi u konstatua se për realizimin e këtij projekti është realizuar procedura e prokurimit e cila u nda në 7 lote dhe u zhvillua në datë 29.09.2015, mbas vlerësimit të ofertave të së cilës u lidhën kontratat përkatëse me katër operatorë, respektivisht I. (për lotin 1,3,5,6) me vlerë 2.313.621,95 Euro, A. V. & T për Lotin 2 me vlerë 557.371,00 Euro, C. M. S. për Lotin 4 në vlerën 636.750,00 Euro dhe A. për Lotin 7 në vlerën 455.230,00 Euro si dhe shtesat për të katër kontratat të cilat janë në vlerën 1.037.028 Euro. Lotet përgjithësisht përfshinin të gjithë zërat e rënë dakord në marrëveshjen bazë të programit me përjashtim të rezonancës magnetike, e cila për shkak të vlerës të konsiderueshme është menduar të zëvendësohet me pajisje të tjera mjekësore që në fazën e hartimit të dokumenteve të tenderit.

Për periudhën nga fillimi i projektit deri në vitin 2014, nuk është përmbushur asnjë nga komponentët e tij. Për periudhën objekt auditimi, kur projekti ka përfunduar grupi i auditimit refuzon të japi opinion pasi nuk është hartuar raporti i vlerësimit përfundimtar nga spitali i traumës si përfituesi direkt i kredisë së ndihmës, në zbatim të nenit 15, pika 5 e të Ligjit nr. 9617, datë 16.10.2006.

Pasi në zbatim të nenit 5 të marrëveshjes një Raporti Përfundimtar (RP) do të përgatitet nga Drejtoria e Spitalit Ushtarak të Tiranës në fund të projektit pasi të ketë marrë më parë miratimin e MSH, ai i dërgohet MPJ/DPKZH. RP do të ketë këtë strukturë të përgjithshme duke përfshirë një përmbledhje të përmbajtjes së projektit, përshkrim të modaliteteve të zbatimit të projektit (tenderët, kalendari, shumat, realizime e ndryshime, kosto, financimi, performancë e ndërmarrjeve dhe enti zbatues), performancë e projektit (operative, institucionale e financiare), ndikimet (ekonomike, shoqërore, mjedisore etj.), qëndrueshmëria e projektit, performancë e DPKZH dhe Qeverisë, performancë e përgjithshme, përfundime e rekomandime. Një raport i tillë nuk rezulton të jetë përgatitur edhe pse projekti ka përfunduar.

Në nenin 6 të marrëveshjes së programit sqarohet se programi do të monitorohet përmes një komiteti drejtues, i përbërë nga dy anëtarë të caktuar, njëri nga MPJ/DPKZH dhe tjetri nga MM (ndryshuar në MSH sipas marrëveshjeve të sipërpërmendura) detyra kryesore e këtij komiteti do të ishte monitorimi i veprimtarive të përfshira në program, veçanërisht: - marrëdhëniet mes institucioneve të përfshira në të; - shqyrtimi i dokumentacionit të tenderit përgatitur nga përfituesi i tij dhe asistimi, nëse do të ishte i nevojshëm, i përgatitjes së tenderit në lidhje me procedurat e prokurimit; - dhënia e ndihmës për grupin e ekspertëve shqiptarë të përcaktuar nga MM, (aktualisht MSH); - si dhe monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të Programit. Aktiviteti i këtij komiteti drejtues duhet të zhvillohej nëpërmjet mbledhjeve ku duhet të zhvilloheshin mendimet dhe të merreshin parasysh propozimet dhe masat e përbashkëta për fazat e mëtejshme të realizimit. Për çdo vendim në lidhje me programin duhet të merrej mendimi i komitetit dhe në përfundim të Programit duhet të thirrej një mbledhje për të bërë një analizë përfundimtare të kontrollit të veprimtarive të Programit.

Nga auditimi u konstatua se një komiteti i tillë nuk është ngritur dhe për pasoje asnjë nga detyrat të cilat citohen në program për të nuk rezulton të jetë kryer. Nuk ka monitorime dhe vlerësime të programit që nga faza e fillimit të tij. Nuk ka takime pune ku të evidentohen propozimet e bëra për realizimin e programit dhe nuk ka vendime të këtij komiteti në lidhje me faza të ndryshme të ecurisë së programit. Nuk rezulton asnjë analizë përfundimtare të kontrollit të veprimtarive të programit.

Përveç sa mësipër, nuk ka gjurmë auditimi për dokumentimin e fazave të tij, si dhe në ndjekjen dhe monitorimin e projektit nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për menaxhimin e tij, në përputhje me përcaktimin e sanksionuar në Marrëveshjen bazë, **ku përcaktohet se MSH duhet të kujdeset për koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe menaxhuese të nevojshme për realizimin e programit.**

Gjatë fazës së implementimit të tij nga Ministria e Shëndetësisë kur janë caktuar drejtuesit e programit, nuk janë caktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të përfshirë në

implementimin e projektit dhe dorëzimi i dokumentacionit nga njëri staf në tjetrin nuk është dokumentuar.

Me urdhër të ministrit të Shëndetësisë nr. 533, datë 05.12.2016, është ngritur grupi që do të merret me koordinimin e funksioneve të natyrës teknike, financiare dhe menaxhuese të nevojshme *për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave* që janë lidhur me operatorët ekonomikë fitues dhe Ministrisë së Shëndetësisë për realizimin e programit. Njësia përbëhet nga E. Z. jurist, L. P. inxhinier biomedikale, S. Ç. ekonomist, A. Z. zv. Drejtor i Spitalit të Traumës, ky urdhër ka ndryshuar me urdhrin nr. 102 datë 23.02.2017 ku është zëvendësuar z. E. Z. me z. E. V., përgjegjës i sektorit të koncesioneve pranë drejtorisë së prokurimeve dhe më vonë me urdhrin nr. 153, datë 20.03.2017 ku z. V. është ndryshuar me zj. A. A., përgjegjëse e sektorit të prokurimeve pranë drejtorisë së prokurimeve, investimeve dhe koncesioneve. Ndërsa mbas ristrukturimit të kabinetit qeveritar në vitin 2017 ku Ministrisë së Shëndetësisë iu shtua edhe Mbrojtja Sociale, me urdhrin nr. 591, datë 20.12.2017 të ministrit është caktuar zj. D. S. si personi përgjegjës për ndjekjen e projektit. Me Urdhrin nr. 73, datë 06.02.2020 "Për caktimin e personit përgjegjës për projektet në kuadër të marrëveshjeve mes Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Italiane" është caktuar zj. J. J. si person përgjegjës për ndjekjen e projektit.

Nga auditimi u konstatua se projekti në bazë të marrëveshjes duhet të niste në vitin 2006, por konstatojmë se realizimi i procedurave të prokurimit është bërë me shumë vonesë, në vitin 2015. Referuar shkresës nr. 1179/29 datë 23.11.2016 të ministrit të kohës, *implementimi real i tij ka filluar në vitin 2014* kur janë evidentuar nevojat fillestare të spitalit nga ing. F. R. ekspert biomedical, i Cooperazione Italiana.

Nga sa më lart, konstatojmë se nga palët përgjegjëse për zbatimin e projektit, nuk është përcaktuar një afat për përfundimin e projektit, si dhe një grafik kohe për jetëgjatësinë dhe ecurinë në vite, nuk është hartuar një dokument i vlerësimit të projektit, veprime të cilat kanë sjellë një zvarritje të tij (projektit).

Midis dy palëve MSH dhe palës italiane, për mos implementimin e projektit në kohë nuk është bërë një riaktivizim i projektit apo një program që cakton radhën e veprimeve në vazhdimësi, veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të Marrëveshjes së kredisë, ku përcaktohet se nëse zgjatja e pengesave është më e madhe se 24 muaj, palët janë të detyruara të bien dakord mbi vazhdimin e projektit dhe të caktojnë radhën e veprimeve.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi menaxhmentin dhe strukturat e përfshirë në këtë proces.

2.4 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit nr. 134/1, datë 08/02/2024 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Përcaktimet e Ligjit nr. 9617, datë 16.10.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".
2. Përcaktimet e Ligjit nr.9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa Spa për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".
3. Urdhër shpenzimet për pagesat e TVSH.
4. Praktikat e pagesave të kryera.
5. Raportimet në MF.

6. Akte shkresore për komunikimin me donatorin.
7. Akte shkresore për komunikimi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
8. Akte Shkresore për komunikimin me Bankën Agjente në Shqipëri.
9. Dokumentacioni shoqërues i pagesave.
10. Etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Në bazë të nenit 5 “Burimet financiare dhe Modalitetet e përdorimit të kredisë së ndihmës”, parashikohet:

a) Burimet financiare të nevojshme për realizimin e Programit janë si vijon:

1. Kredia ndihmëse prej 5,000,000 Euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në Program.

2. Donacion prej 150,000 euro për veprimtaritë e kontrollit dhe asistencës teknike si gjatë shpalljes së tenderave, ashtu dhe gjatë zbatimit të veprimtarive të Programit.

b) Afatet dhe kushtet e kredisë ndihmëse janë si vijon:

- periudha e kthimit të kredisë: 19 vjet

- periudha e faljes (për kthimin e kredisë): 8 vjet

- përqindja e interesit vjetor: 0.20%.

c) Në bazë të procedurave në fuqi pranë MPJ/DPKZH, fazat kryesore, që duhen ndjekur për përdorimin e fondeve të kredisë ndihmëse, janë si më poshtë (më mirë specifikuar në aneksin 3):

1. nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje;

2. nxjerrja nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane e një urdhri ministror, që autorizon Artigiancassa të negociojë dhe nënshkruajë Marrëveshjen Financiare me Ministrinë e Financave;

3. lidhja e Marrëveshjes financiare mes Artigiancassa dhe MF;

4. përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i tenderit, për të përcaktuar ata që do të ofrojnë furnizimet, shërbimin e asistencës, mirëmbajtjes dhe trajnimit me shpalljen e tenderit në Itali (në ngarkim të MPJ/DPKZH) dhe në Shqipëri (në ngarkim të MM);

5. vlerësimi i ofertave nga ana e komisionit të ngritur nga MM dhe shpallja, me klauzolë pezulluese, e fituesit të tenderit;

6. verifikim, nga ana e MPJ/DPKZH, i përputhshmërisë së procedurës së ndjekur për përzgjedhjen dhe kontratat që do të lidhen, dhe në rast përfundimi pozitiv, kjo e fundit do të japë no objection (miratohet pasi nuk ka kundërshtime) për lidhjen e kontratës së furnizimit nga ana e MM;

7. lidhja dhe llogaritja e kontratave mbi bazën e Marrëveshjes financiare, me modalitetet e livrimit të fondeve të treguara në aneksin 3.

Në nenin 8 “Detyrime të qeverisë italiane” parashikohet që:

a) Qeveria Italiane merr përsipër të sigurojë financimin:

- deri në 5,000,000.00 euro si kredi ndihme, që do të jetë e disponueshme pranë Artigiancassa dhe do të livrohet sipas sa saktësuar në aneksin 3;

- deri në 150,000.00 euro, si donacion, që do të administrohet drejtpërsëdrejti nga MPJ/DPKZH për kontraktimin e ekspertëve dhe konsulentëve për veprimtarinë e kontrollit dhe menxhimit të kredisë.

Në nenin 9 “Detyrime të Qeverisë Shqiptare” parashikohet që:

a) Qeveria Shqiptare merr përsipër:

- të vërë në dispozicion burimet financiare në kompetencë të saj, të barabarta me rreth 1,000,000.00 Euro të barasvlershme;

- t'i bëjë operative të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet zyrtare të domosdoshme për përfundimin me sukses të Programit;

- të bashkëpunojë me MPJ/DPKZH për veprimtaritë e monitorimit të Programit, sipas nenit 6, edhe që kjo e fundit të mund të ketë akses ndaj dokumentacionit ekzistues dhe në hapësirat ku ai vepron.

Gjatë periudhës së auditimit grupit të auditimit nuk ju vendosë në dispozicion dokumentacioni i mësipërm me qëllim vlerësimin e plotësimit të kërkesave nga ana e qeverisë shqiptare dhe afatet e plotësimit.

Aneksi 1 i Marrëveshjes së Programit parashikon kostot në ngarkim të Kooperacionit Italian

Tabela 1 – Kuadri i Përgjithshëm i kostove të programit

	Kostot e programit	Totali (€)	Shuma (€)
A.	Pajisje mjekësore dhe orendi	4,600,000	
A.1	Pajisje e ndihmës së shpejt (Urgjenca)		805,000
A.2	Pajisje Blloku operator (Sallat e operacionit)		1,430,000
A.3	Pajisje e Repartit të reanimacionit (Terapia intensive)		630,000
A.4	Pajisje të Repartit të shtrimeve		360,000
A.5	Pajisje e Shërbimit të Bioimazheve		1,205,000
A.6	Pajisje e Morgut		50,000
A.7	Energji elektrike e vazhduar		80,000
B.	Shërbimi i Asistencës, Mirëmbajtjes, Trajnimit	220,000	
C.	Materiale Shërbimimi dhe Pjesë Këmbimi	180,000	
	Kredi	5,000,000	
D.	Misione të DPKZH	150,000	
D.1	Viti 2006		100,000
D.2	Viti 2007		50,000
	Donacioni (Fondi për Ekspertë)	150,000	
	Totali i përgjithshëm i programit	5,150,000	

Burimi: Ligji i Marrëveshjes së Programit

Për të rregulluar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Programit dhe mënyrën sesi do të zbatohet financimet që lidhen me huanë e butë është nënshkruar marrëveshja financiare ratifikuar me Ligjin nr.9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa Spa për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës" ku janë përcaktuar më qartë termat e financimit të kredisë dhe shlyerja e saj, konkretisht:

Shuma maksimale e kredisë 5,000,000 Euro me kohëzgjatje 19 vjet dhe shlyerja e kredisë në 22 këste të principalit të barabarta gjysmëvjetore të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve bëhet i pagueshëm 102 (njëqind e dy) muaj prej datës së disbursimit të parë me normë interesit nominale 0.20% në vit (zero pikë njëzet për qind) e pagueshme në fund të çdo periudhe të 6 (gjashtë) muajve prej datës së çdo tërheqjeje. Në zbatim të këtij neni të marrëveshjes deri në fund të 31.12.2018 u konstatua se janë disbursuar 4,996,500 Euro. Për pjesën e interesit të paguar nga pala shqiptare për kredinë deri në 31.12.2023 grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion informacioni.

KONTRAKTORI	SKEDULI	Fondi i parashikuar per financim	SHUMA	DATA E DISBURSIMIT
A. SPA	1	761,100	159,187.50	27.06.2018
V. SRL	2	807,721.50	139,342.75	03.07.2018
A. SPA	3	761,100	357,336.25	06.07.2018

A. SPA	4	761,100	120,226.25	06.07.2018
I. SPA	5	2,885,334	1,796,920.58	11.07.2018
I. SPA	6	2,885,334	449,982.58	11.07.2018
I. SPA	7	2,885,334	29,419.51	23.07.2018
I. SPA	8	2,885,334	12,741.83	23.07.2018
I. SPA	9	2,885,334	24,557.45	23.07.2018
V. SRL	10	807,721.50	418,028.25	26.07.2018
A. I. SPA	11	545,870	364,184.00	06.08.2018
A. I. SPA	12	545,870	91,046.00	06.08.2018
A. I. SPA	13	545,870	72,512.00	06.08.2018
A. I. SPA	14	545,870	18,128.00	11.10.2018
V. SRL	15	807,721.50	246,825.05	06.02.2019
I. SPA	16	2,885,334	500,382.84	13.06.2019
I. SPA	17	2,885,334	71,329.52	18.05.2020
A. SPA	18	761,100	124,350	02.07.2020
TOTALI			4,996,500.36	

Referuar Neni 10 “Dorëzimi i njohjes së borxhit”

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike prej datës së skadimit të disbursimit të fundit të huasë së butë të parashtruar në nenin 5.1, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do t’i dorëzojë Artigiancassa-s njohjen e borxhit të nënshkruar siç duhet dhe të sigluar në çdo faqe në formularin e shtojcës E).

10.2 Pasqyra e shlyerjeve e parashtruar në njohjen e borxhit do të plotësohet duke mbledhur të gjitha këstet e principalit dhe të interesit ende të pamaturuara dhe këstet të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar në datën e dorëzimit të njohjes së borxhit, të parashikuara në pasqyrën e shlyerjeve përkatëse për çdo disbursim, në përputhje me kushtet e nenit 8.6.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë njohjen e borxhit për regjistrim dhe administrim të saj dhe herë pas here do të shënojë në njohjen e borxhit pagesat e principalit dhe të interesit së bashku me këstet e mundshme, të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar. Sapo të jenë bërë të gjitha pagesat e parashikuara në njohjen e borxhit, Artigiancassa do t’i kthejë njohjen e borxhit Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë të nënshkruar siç duhet e të vërtetuar.

Deri në fund të periudhës objekt auditimi u konstatua se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka paguar për kredinën prej 5,000,000 Euro (disbursuar 4,996,500.36 euro) për projektin "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

Referuar nenit 4 “Hyryra në fuqi e Marrëveshjes financiare”

4.1 Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive pasi Artigiancassa të ketë marrë prej Huamarrësit dokumentet e mëposhtme përmes Ambasadës Italiane - Ambasada/Zyra e bashkëpunimit:

i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke pasqyruar autoritetin e Huamarrësit për të nënshkruar në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë këtë Marrëveshje nga një person i autorizuar në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe vepruese në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet e lindura nga kjo Marrëveshje;

ii) Emërimin me shkrim nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë të personit/personave të autorizuar në mënyrë të rregullt për të nënshkruar këtë Marrëveshje (të vërtetuar nga Ambasada Italiane në Tiranë – Ambasada/Zyra e bashkëpunimit), kërkesa për financim e kontratës së furnizimit në formularin e shtojcës A) dhe njohjen e borxhit në formularin e shtojcës C) referuar nenit 10 më poshtë. Ky përcaktim do të specifikojë emrin dhe zyrën e këtij personi/personave dhe të përmbajë “modelin” e përditësuar të firmave të tyre. Ndonjë ndryshim i kësaj (nëse ka) do të transmetohet në kohë nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë tek Artigiancassa;

iii) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me caktimin e Bankës Agjente Shqiptare, duke i kërkuar autoritetit të Bankës Agjente Shqiptare të veprjë në emër dhe për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Pasi të ketë marrë dokumentet e lartpërmendura dhe të jetë në pajtim të plotë me to, Artigiancassa do të njoftojë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Shqiptare Agjente me anë të një letre ose faksit, që më pas do të konfirmojë me anë të letrës, datën në të cilën kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi.

Referuar Nenit 5 “Afatet për disbursimin e huasë së butë”

5.1 Periudha e disbursimit të huasë së butë do të jetë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e disbursimit të parë. Kjo periudhë mund të zgjatet nga Artigiancassa. Artigiancassa nuk mund të zgjasë periudhën e disbursimit në rast se Huamarrësi ose autoritetet kompetente italiane nuk janë dakord për këtë shtyrje dhe të kenë njoftuar për këtë me shkrim Artigiancassa-n, së paku 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para skadimit të datës së periudhës së disbursimit.

5.2 Në rast se periudha e disbursimit ka skaduar dhe nuk mund të zgjatet, Artigiancassa, pasi të jetë konsultuar me autoritetet kompetente italiane, do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa-s në lidhje me fondet e papërdorura.

Nga auditimi u konstatua se disbursimi i parë është në datën 27.06.2018 dhe ka përfunduar brenda periudhës së efektivitetit të tij, pagesa e fundit datë 02.07.2020.

Personat që kanë autorizuar pagesat.

Me shkresën nr. 1179/27, datë 04.11.2016 “Kërkesë për depozitimin e specimenteve të firmave për personat e autorizuar të Ministrisë së Shëndetësisë, për zbatimin e Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane për realizimin e Programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” – kredi e qeverisë italiane AID N. 8098.6.0” kanë caktuar persona të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Z. A. Ç. – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë
2. Z. R. C. – Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve, Investimeve dhe Konkencioneve

Me shkresën nr. 970/6, datë 19.04.2017 “Kërkesë për depozitimin e specimenteve të firmave për personat e autorizuar të Ministrisë së Shëndetësisë, për zbatimin e Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane për realizimin e Programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” – kredi e qeverisë italiane AID N. 8098.6.0” kanë caktuar persona të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Z. K. N. (M.) – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë
2. Z. R. C. – Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve, Investimeve dhe Konkencioneve

Me shkresën nr. 5687/2, datë 03.07.2017 me subjekt “Marrëveshja Financiare F.ROT./AID 06/003” Ministria e Financave ka përcjell depozitimin e firmave tek Banka Intesa Paolo dhe Cassa Depositi e Prestiti. Me emailin e datës 01.08.2017 Banka ka informuar PIU-n për depozitimin e firmave.

Me shkresën nr. 2612/14, datë 07.11.2017 “Kërkesë për depozitimin e specimenteve të firmave për personat e autorizuar të Ministrisë së Shëndetësisë, për zbatimin e Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane për realizimin e Programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” – kredi e qeverisë italiane AID N. 8098.6.0” kanë caktuar persona të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Z. A. K. – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë
2. Z. R. C. – Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve, Investimeve dhe Konkencioneve

Me shkresën nr. 2612/20, datë 22.12.2017 “Kërkesë për depozitimin e specimenteve të firmave për personat e autorizuar të Ministrisë së Shëndetësisë, për zbatimin e Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane për realizimin e Programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” – kredi e qeverisë italiane AID N. 8098.6.0” kanë caktuar persona të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Z. A. K. – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë

2. Z. D. S. – Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Me shkresën nr. 3251, datë 16.05.2018 “Kërkesë për depozitimin e specimenteve të firmave për personat e autorizuar të Ministrisë së Shëndetësisë, për zbatimin e Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane për realizimin e Programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” – kredi e qeverisë italiane AID N. 8098.6.0” kanë caktuar persona të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Z. M. Xh. – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Z. D. S. – Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Me shkresën nr. 102/1, datë 28.01.2019 “Kërkesë për depozitimin e specimenteve të firmave për personat e autorizuar të Ministrisë së Shëndetësisë, për zbatimin e Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane për realizimin e Programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” kanë caktuar persona të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Z. A. K. – Sekretar i Përgjithshëm.
2. Z. D. S. – Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Me shkresën nr. 8278/2, datë 27.05.2019 “Financial Agreement” kanë caktuar persona të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Z. G. P. – Sekretar i Përgjithshëm.
2. Z. D. S. – Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Me shkresën nr. 913, datë 17.02.2019 “Kërkesë për depozitimin e specimenteve të firmave për personat e autorizuar të Ministrisë së Shëndetësisë, për zbatimin e Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane për realizimin e Programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” kanë caktuar persona të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Z. G. P. – Sekretar i Përgjithshëm.
2. Z. J. J. – Drejtor i Drejtorisë së Konkencioneve, PPP dhe Prokurimeve.

Pagesat e TVSH dhe kosto lokale

Referuar Nenit 3 të Ligjit nr. 9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa Spa për financimin e programit ‘Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës’" huaja e butë nuk mund të përdoret për të financuar taksat lokale, taksat doganore dhe TVSH-në.

Për këtë qëllim Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paguar TVSH në doganë për të gjitha dërgesat e kryera nga kompanitë italiane në Republikën e Shqipërisë. Deri në fund të periudhës së auditimit janë kryer gjithsej 36 pagesa në total 133,916 mijë lekë.

Nga auditimi i fundit i kryer në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin janë kryer vetëm dy pagesa TVSH pas përfundimit të auditimit të mëparshëm i cili ka pasur periudhë auditimit deri në 31.12.2018:

- Me Urdhërshpenzimin nr.954, datë 11.12.2019 është kryer pagesa e TVSH ndaj DPD Dega Tiranë në vlerën 756,676 lekë. Bashkëlidhur Deklarat doganore pa datë, për pajisjen Neurosurgery Handpieces, Fatura nr. 201905000031 I., datë 25.10.2019 me vlerë 30,696.81 euro, Packing List, Dokument transport (CMR)

- Me Urdhërshpenzimin nr.167, datë 09.03.2020 është kryer pagesa e TVSH ndaj DPD Dega Tiranë në vlerën 222,293 lekë. Bashkëlidhur Deklarat doganore pa datë, për pajisjen

Refrigerated centrifuge, bench, ëith usb dhe shaker, Fatura nr. 201905000036 I., datë 11.12.2019 me vlerë 8,945.45 euro, Packing List, Dokument transport (CMR)

Tabela nr. 4: Pagesat për TVSH, taksa doganore dhe kosto lokale

									<i>Në/mijë lekë</i>
Nr	Emërtimi	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Totali
1	TVSH	-	-	-	129,215	3,722	757	222	133,916
2	Taksë doganore	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Kosto lokale	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Totali	-	-	-	129,215	3,722	757	222	133,916

Burimi i të dhënave: Ministria e Shëndetësisë

Në zbatim të Ligjit Nr. 9617, datë 16.10.2006 dhe Ligjit nr. 9656, datë 11.12.2006 Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka lidhur kontratat e sipër cituara.

Kontratat e lidhura si më lartë në interpretim të Konventës së Vjenës të muajit maj 2009, Ligjit nr. 10 092, datë 09.03.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave”, si dhe doktrinës dhe jurisprondencës ndërkombëtare për shitjen e mallrave, kanë lënë shteg për keqinterpretime në zbatimin e tyre dhe në vecanti për eliminimin e tatimit të dyfishtë.

Për realizimin e plotë të projektit, në zbatim të kontratave respektive kontraktorët/kompanitë Italiane kanë përfituar në total vlerën 4,996,500.36 euro. Në mënyrë të detajuar:

1. Kontratë Nr. 1179/16 firmosur në datë 30.03.2016 për shumën EURO 2,313,621.95 me kontraktorin *I. S.* dhe Adendum Nr. 970/4 datë 07.03.2017 me vlerë 571,712.29 Euro. Kontraktori/kompania Italiane *I. S.* ka përfituar në total vlerën 2,885,334.1 euro.

2. Kontratë Nr. 1179/15 firmosur në datë 30.03.2016 për shumën EURO 557,371.00 me kontraktorin *A.V. Srl & T. Srl* dhe Adendum Nr. 970/1 datë 21.02.2017 me vlerë 250,350.50 Euro. Kontraktori/kompania Italiane “*A.V. Srl & T. Srl*” ka përfituar në total vlerën 804,196.05 euro.

3. Kontratë Nr. 1179/13 firmosur ne date 25.03.2016 për shumën EURO 636,750.00 me kontraktorin *C. M. S. S.p.A* dhe Adendum Nr. 970/2 datë 23.02.2017 me vlerë 124,350 Euro. Kontraktori/kompania Italiane “*C. M. S. S.p.A*” ka përfituar në total vlerën 761,100 euro.

4. Kontratë Nr. 1179/18 firmosur ne date 11.04.2016 për shumën EURO 455,230.00 me kontraktorin *A. I. S.p.A* dhe Adendum Nr. 970/3 datë 24.02.2017 me vlerë 90,640 Euro. Kontraktori/kompania Italiane “*A. I. S.p.A* dhe Adendum” ka përfituar në total vlerën 545,870 euro.

Për këtë vlerë nuk është vlerësuar/marrë në konsideratë mbajtja tatimit mbi të ardhurat në vlerën 749,475.054 euro (4,996,500.36 x 15 %).

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale dhe kontraktorët/kompanitë Italiane nuk kanë aplikuar dhe dorëzuar në organet tatimore formularët për eliminimin e tatimit të dyfishtë.

Ministria nuk i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për interpretim lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për të dhënë argument shterues për mbajtjen ose jo të tatimit mbi të ardhurat, për të shmangur keqinterpretimet e zbatimit të dispozitave të poshtë shënuara në lidhje me këtë çështje. Konkretisht:

-Ligji Nr.9617, datë 16.10.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga ministria e punëve të jashtme, për realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

-Ligji nr. 9656, datë 11.12.2006 “Për ratifikimin e “marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e financave dhe artigiancassa spa për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

-Ligji nr. 10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

-Ligji nr. 10 092, datë 09.03.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave”.

-Ligji nr. 8371 datë 09.07.1998 “Për Lidhjen e Marrëveshjeve dhe Traktateve Ndërkombëtare”.

- Udhëzimi nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”.

Konkluzione:

Kjo situatë ka ardhur si pasojë e mos vëmendjes së duhur institucionale dhe përgjegjësisë ndaj detyrës së strukturave të përfshirë në këtë proces, duke filluar nga nivele të larta menaxheriale/drejtuese.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi menaxhmentin dhe strukturat e përfshirë në këtë proces.

2.5 Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.

Në zbatim të pikës 5⁴ të Programit të Auditimit nr. 134/1, datë 08/02/2024.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi (01.01.2019-31.12.2023) Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale nuk ka zhvilluar asnjë procedurë prokurimi për projektin "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës" sipas marrëveshjes së ratifikuar me Ligjin nr. 9617, datë 16.10.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës", në formën e kredisë ndihmëse në shumën 5,000,000 Euro dhe një donacion në shumën 150,000 Euro.

Bazuar në këtë marrëveshje është nënshkruar Marrëveshja Financiare midis Ministrisë së Financave dhe Artigiancassa Spa ratifikuar me Ligjin nr.9656, datë 11.12.2006 për ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa spa për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

Për periudhën nga fillimi i projektit deri në 31.12.2018, periudhë e cila është audituar, janë zhvilluar:

Më datë 29.07.2015 Ministria e Shëndetësisë ka publikuar njoftimin për zhvillimin e procedurave të prokurimit me objekt “Fuqizimin e Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”. Në këtë akt parashikohet se kredia e ndihmës do të përdoret për blerjen e pajisjeve mjekësore dhe pajisjeve për Qendrën Traumatologjike Kombëtare të Tiranës, fondet për të cilën janë të ndara në shtatë lote, me këto vlera:

Loti 1. Monitoraggio/Pensili/Aria Medica	1,260,000
Loti 2. Diagnostica/Miscellanea	830,000
Loti 3. Endoscopia	460,000
Loti 4. Radiologia/Ecografia	750,000
Loti 5. Laboratorio	335,000
Loti 6. Blocco Operatorio	840,000

⁴ Trajtuar edhe në Raportin e Auditimit të projektit deri në datë 31.12.2018

Në përputhje me parashikimet e njoftimit për zhvillimin e procedurave të prokurimit, bazuar në procesverbalin nr.1, datë 29.09.2015, evidentojmë se kanë paraqitur oferta këta operatorë ekonomik:

1. S.- ofertë për Lotin 1 dhe 2;
2. V. & T.- ofertë për Lotin 2 dhe 6;
3. C. M. S.- ofertë për Lotin 4;
4. C. M. & S.- ofertë për Lotin 1, 2, 4 dhe 6;
5. A.- ofertë për Lotin 1 dhe 7;
6. I.- ofertë për Lotin 1,2,3,4,5,6 dhe 7;
7. T. G.- ofertë për Lotin 1,2,3,4 dhe 6.

Pas përfundimit të procedurave tenderuese janë lidhur kontratat:

Kontrata Nr. 1179/16 firmosur në datë 30.03.2016 me I. (për lotin 1,3,5,6) me vlerë 2.313.621,95 Euro

Kontrata Nr. 1179/15 firmosur në datë 30.03.2016 me A. V. &T. për Lotin 2 me vlerë 557.371,00 Euro,

Kontrata Nr. 1179/13 firmosur në datë 25.03.2016 me C. M. S. për Lotin 4 në vlerën 636.750,00 Euro

Kontrata Nr. 1179/18 firmosur në datë 11.04.2016 me A. për Lotin 7 në vlerën 455.230,00 Euro

Për pjesën vijuese nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi.

2.6 Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit nr. 134/1, datë 08/02/2024 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Kontrata Nr. 1179/16 firmosur në datë 30.03.2016 me vlerë 2,313,622 euro me kontraktorin “I. S.” dhe Adendum Nr. 970/4 datë 07.03.2017 me vlerë 571,712 euro.

-Kontrata Nr. 1179/15 firmosur në datë 30.03.2016 me vlerë 557,371 euro me kontraktorin “A. V. & T. S.” dhe Adendum Nr. 970/1 datë 21.02.2017 me vlerë 250,351 euro.

-Kontrata Nr. 1179/13 firmosur në datë 25.03.2016 me vlerë 636,750.00 euro me kontraktorin “C. M. S. S.p.A” dhe Adendum Nr. 970/2 datë 23.02.2017 me vlerë 124,350 euro.

-Kontrata Nr. 1179/18 firmosur në datë 11.04.2016 me vlerë 455,230 euro me kontraktorin “A. I. S.p.A” dhe Adendum Nr. 970/3 datë 24.02.2017 me vlerë 90,640 euro.

- Dokumentat e lëvrimin të mallrave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Në zbatim të Ligjit Nr. 9617, datë 16.10.2006 dhe Ligjit nr. 9656, datë 11.12.2006 Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka lidhur kontratat e sipërcituara.

Kontratat e lidhura si më poshtë:

1. Kontratë Nr. 1179/16 firmosur në datë 30.03.2016 për shumën EURO 2,313,621.95 me kontraktorin I. S. dhe Adendum Nr. 970/4 datë 07.03.2017 me vlerë 571,712.29 Euro.

2. Kontratë Nr. 1179/15 firmosur në datë 30.03.2016 për shumën EURO 557,371.00 me kontraktorin A.V. Srl & T. Srl dhe Adendum Nr. 970/1 datë 21.02.2017 me vlerë 250,350.50 Euro.

3. Kontratë Nr. 1179/13 firmosur ne date 25.03.2016 për shumën EURO 636,750.00 me kontraktorin C. M. S. S.p.A dhe Adendum Nr. 970/2 datë 23.02.2017 me vlerë 124,350 Euro.

4. Kontratë Nr. 1179/18 firmosur ne date 11.04.2016 për shumën EURO 455,230.00 me kontraktorin A. I. S.p.A dhe Adendum Nr. 970/3 datë 24.02.2017 me vlerë 90,640 Euro.

Për realizimin e plotë të projektit, në zbatim të kontratave respektive kontraktorët/kompanitë Italiane kanë përfituar në total vlerën 4,996,500.36 euro. Në mënyrë të detajuar:

Kontraktori/kompania Italiane *I. S.* ka përfituar në total vlerën 2,885,334.1 euro.

Kontraktori/kompania Italiane "*A. V. Srl & T. Srl*" ka përfituar në total vlerën 804,196.05 euro.

Kontraktori/kompania Italiane "*C. M. S. S.p.A*" ka përfituar në total vlerën 761,100 euro.

Kontraktori/kompania Italiane "*A. I. S.p.A dhe Adendum*" ka përfituar në total vlerën 545,870 euro.

Për periudhën 01.01.2019 deri në 31.12.2023 u konstatuan se janë kryer 4 pagesa ndaj Kontraktorëve me vlerë totale **942,884 euro**, konkretisht:

Kontraktori/kompania Italiane "*I. S.*" dhe Adendum ka përfituar në total vlerën 571,712.36 euro.

-Kontraktori/kompania Italiane "*A. V. Srl & T. Srl*" dhe Adendum ka përfituar në total vlerën 246,825.05 euro.

-Kontraktori/kompania Italiane "*C. M. S. S.p.A*" dhe Adendum ka përfituar në total vlerën 124,350 euro.

Referuar Shtesave të Kontratave (Adendum), për sa i përket afateve, çmimeve dhe instalimit do të zbatohen kushtet e kontratës bazë (çmimi, instalimi, koha e zbatimit).

Referuar pikës 7 të Kontratës së lidhur "Termat e dorëzimit dhe penalitetet për vonesat"

"Data e hyrjes në fuqi të detyrimeve kontraktuale është data e njoftimit, nga ana e Institucionit Financiar (Gestore del fondo rotativo), e hyrjes së vlerës së kontratës në linjën e kredisë"

Ka një standard të dyfishtë në futjen në linjën e kredisë për shtesat e kontratave nga Institucioni Financiar, konkretisht:

1. Kontratë Adendum Nr. 970/4 datë 07.03.2017 me kontraktorin *I. S.* dhe me vlerë 571,712.29 Euro ka hyrë në linjën e kredisë në datë 12.07.2018.

2. Kontratë Adendum Nr. 970/1 datë 21.02.2017 Nr. 1179/15 me kontraktorin *A. V. Srl & T. Srl* dhe me vlerë 250,350.50 Euro ka hyrë në linjën e kredisë në datë 17.07.2018.

3. Kontratë Adendum Nr. 970/2 datë 23.02.2017 me kontraktorin *C. M. S. S.p.A* me vlerë 124,350 Euro ka hyrë në linjën e kredisë në datë 13.11.2018.

4. Kontratë Nr. 1179/18 Adendum Nr. 970/3 datë 24.02.2017 me kontraktorin *A. I. S.p.A* dhe me vlerë 90,640 Euro ka hyrë në linjën e kredisë në datë 13.08.2017.

Për sa më sipër kontraktorët kanë marr për sipër furnizimin me pajisje para datës së fillimit të detyrimeve kontraktuale (datë e hyrjes në linjën e kredisë).

Në kontratat e lidhura me kontraktorët/kompanitë italiane të përmendura si më sipër, është përcaktuar në nenin 29, pika 29.2

- Fatura commerciale

- Dokumenti i imbakimit

- Packing list

- Policë sigurimi

- Certifikatë origjine

-Certifikatë Garancie

Dokumenta të cilat duhet ti dorëzohen Ministrisë 1 javë para dërgesës ose 1 ditë para nisjes nga porti i vendit të origjinës.

Me shkresën nr. 2930/2, datë 02.07.2020 të MSHMS është autorizuar pagesa prej **124,350 euro** për kontraktorin *C. M. S. Spa* për Adendumin nr. 970/2, datë 23.02.2017, për pajisjet:

në euro

Nr.	Pajisje	Sasia	Cmimi
1.	Ecograpi, shumëpërdorimshe, ngjyra, dopler	2	73,050
2.	X-Ray, C-Arm, dixhitale, e levizshme	1	51,300
	Totali		124,350

Burimi: MSHMS

Pajisjet janë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

-Fatura commerciale nr. FTV17-00927 datë 19/12/2017 me vlerë prej 124,350 euro

-Certifikatë origjine nr. 0941103 datë 20/03/2017

-CMR datë 21.12.2017

-Packing list datë 19.12.2017

-Certifikatë Garancie nr. 15252

-Policë sigurimi nr. 1/359220/36/131114214/2

-Deklarata doganore

Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 240, datë 06.05.2019

Fletë hyrje nr. 9, datë 20.05.2019

Me shkresën nr. 3418, datë 23.12.2019 “Dërgim dokumentacioni” Spitali Universitar i Traumës ka përcjell dokumentacionin e marrjes në dorëzim të pajisjeve.

Certifikata e Pranimit të Përkohshëm nr. 2930/1, datë 02.07.2020

Me shkresën nr. 163/5, datë 06.02.2019 të MSHMS është autorizuar pagesa prej **246,825,5 euro** për kontraktorin *V. Srl* për Adendumin nr. 970/1, datë 21.02.2017, për pajisjet:

në euro

Nr.	Pajisje	Sasia	Cmimi
1	Pulsosimetro	2	1,028
2	Elettrocardiografo 12 canali	1	3,629
3	Sfigmomanometro con support a rotelle	2	232
4	Ochiali binoculari	4	916
5	Comodino con tavolo per pasto	160	37,120
6	Armadio guardaroba, degenza	55	10,670
7	Sgabello per medici, altezza aggiustabile mobile	10	2,400
8	Armadio di acciaio, stoccaggio materiale sterile, due ante con vetro	2	2,376
9	Armadio di acciaio, stoccaggio material sterile, due ante acciaio	2	2,266
10	Armadio di acciaio, spogliatoio medici, due ante	2	1,590
11	Tavolo servitor, Mayo	6	2,448
12	Tavolo acciaio, fisso, multiuso	3	948
13	Tavolo acciaio, mobile, due ripiani e cassette	2	1,722
14	Lavabo doppio per chirurghi, acciaio inox	2	2,920
15	Lampada battericida, mobile	7	10,283
16	Letto elettro/meccanico UTI	5	18,470
17	Letto meccanico/idraulico degenza	160	98,560
18	Lettino da visita/medicazione 1 snodo	5	1,170
19	Carrelo per medicinali/polifunzionale	3	1,830
20	Sedia a rotelle	3	1,224
21	Barella trasporto paziente	4	2,876
22	Carrelo girovisite porta cartelle/lastre	2	860
23	Carrelo emergenza	2	1,526
24	Carrello di servizio, ambienti sterili	2	424
25	Gruppo inox per sala lavaggio	3	39,337
	Totali		246,825

Burimi: MSHMS

Pajisjet janë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

-Fatura comerciale nr. 389/17 datë 08.05.2017 me vlerë prej 31,947.75 euro

-Certifikatë origjine nr. 41/F për faturën nr. 389/17

- EURO-1

-Packing list 033-6/17 datë 08.03.2017

-Certifikatë Garancie datë 02.02.2017

-Policë sigurimi datë 25.05.2017 me nr. OL/361113805

-Deklarata doganore datë 15.06.2017

-Fatura comerciale nr. 422/17 datë 25.05.2017 me vlerë prej 26,912 euro

-Certifikatë origjine nr. 422/F

- EURO-1

-Packing list 033-5/17 datë 08.03.2017

-Certifikatë Garancie datë 02.03.2017

-Policë sigurimi datë 25.05.2017 me nr. OL/361113805

-Deklarata doganore datë 15.06.2017

-Fatura comerciale nr. 383/17 datë 03.05.2017 me vlerë prej 36,410.62 euro

-Certifikatë origjine nr. 374/F

- EURO-1

-Packing list 033-4/17 datë 08.03.2017

-Certifikatë Garancie datë 02.03.2017

-Polica e sigurimit nuk me përkon me mallrat e kontraktuara nga kompania *V. Srl* por është një policë sigurimi e përgjithshme

-Deklarata doganore datë 24.05.2017

-Fatura comerciale nr. 390/17 datë 07.04.2017 me vlerë prej 26,745 euro

-Certifikatë origjine nr. 375/F

- EURO-1

-Packing list 033-2/17 datë 08.03.2017

-Certifikatë Garancie datë 02.03.2017

-Polica e sigurimit nuk me përkon me mallrat e kontraktuara nga kompania *V. Srl* por është një policë sigurimi e përgjithshme

-Deklarata doganore datë 09.04.2017

-Fatura comerciale nr. 489/17 datë 07.04.2017 me vlerë prej 33,264 euro

-Certifikatë origjine nr. 422/F

- EURO-1

-Packing list 033-3/17 datë 08.03.2017

-Certifikatë Garancie datë 02.03.2017

-Polica e sigurimit nuk me përkon me mallrat e kontraktuara nga kompania *V. Srl* por është një policë sigurimi e përgjithshme

-Deklarata doganore datë 19.04.2017

-Fatura comerciale nr. 307/7 datë 20.04.2017 me vlerë prej 37,017.75 euro

-Certifikatë origjine nr. 321/F

- EURO-1

-Packing list 033-3/17 datë 08.03.2017

-Certifikatë Garancie datë 02.03.2017

-Polica e sigurimit nuk me përkon me mallrat e kontraktuara nga kompania V. Srl por është një policë sigurimi e përgjithshme

-Deklarata doganore datë 08.05.2017

Pajisjet dhe mallrat e ardhura mësipër janë marrë në dorëzim dhe janë bërë hyrje me:

Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 385, datë 05.10.2017

Fletë hyrje nr. 31, datë 05.10.2017

Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 373, datë 02.10.2017

Fletë hyrje nr. 17, datë 02.10.2017

Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 413, datë 06.10.2017

Fletë hyrje nr. 58, datë 06.10.2017

Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 404, datë 06.10.2017

Fletë hyrje nr. 59, datë 06.10.2017

Me shkresën nr. 1138/1, datë 17.10.2017 “Dërgim dokumentacioni” Spitali Universitar i Traumës ka përcjell dokumentacionin e marrjes në dorëzim të pajisjeve

Certifikata e Pranimit të Përkohshëm nr. 3826/3, datë 24.09.2018

Me shkresën nr. 102/9, datë 13.06.2019 të MSHMS është autorizuar pagesa prej **500,382.77 euro** për kontraktorin I. Spa për Adendumin nr. 970/4, datë 07.03.2017, për pajisjet:

në euro

Nr.	Pajisje	Sasia	Cmimi
1	Frigorifero biologico e medicinali	2	9,148.14
2	Microscopio per laboratorio	1	3,26.72
3	Spettrofotometro Ottico	1	10,902.86
4	Elettrobisturi mono/bipolar	4	16,808.36
5	Lampada Scialitica, montata al soffitto, 1 cupola	1	3,559.76
6	Lampada Scialitica, montata al soffitto, 2 cupola	2	13,542.78
7	Lampada Scialitica, mobile	3	6,486.99
8	Tavolo operatorio, Chirurgia generale	1	36,527.75
9	Aspiratore alto vuoto/alta portata	3	3,394.62
10	Aspiratore alto vuoto/media portata	3	2,428.77
11	Aspiratore alto vuoto/bassa portata	2	1,287.10
12	Aspiratore toracico	1	1,581.30
13	PNS, stimolatore nervi periferici	1	15,059.11
14	Purificatore aria, HEPA, portatile	2	8,555.68
	Totali		500,382.84

Burimi: MSHMS

Pajisjet janë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

-Fatura komerciale nr. 201705000030 datë 22.05.2017 me vlerë prej 84,980.35 euro

-Certifikatë origjine nr. T/0931958

-CMR Nr. 39472 datë 23.05.2017

-Packing list

-Certifikatë Garancie me kohëzgjatje 24 muaj

-Polica e sigurimit datë 21.12.2016

-Deklarata doganore pa datë me numër referimi M112

-Fatura commerciale nr. 21705000029 datë 16.05.2017 me vlerë prej 170,277.49 euro

-Certifikatë origjine nr. 0639860

-CMR Nr. 17004461 datë 12.05.2017

-Packing list

-Certifikatë Garancie me kohëzgjatje 24 muaj

-Polica e sigurimit datë 21.12.2016

-Deklarata doganore pa datë me numër referimi 554

- Fatura commerciale nr. 201705245021 datë 07.04.2017 me vlerë prej 18,470.73 euro
- Certifikatë origjine nr. 9689881 datë 20.04.2017
- Dokument transporti ajror MIG-14625
- Packing list
- Certifikatë Garancie me kohëzgjatje 24 muaj
- Polica e sigurimit datë 21.12.2016
- Deklarata doganore pa datë me numër referimi R38697 datë 09.05.2017

- Fatura commerciale nr. 201705000031 datë 29.05.2017 me vlerë prej 61,617.96 euro
- Certifikatë origjine nr. 0639861 datë 08.06.2017
- CMR Nr. 0805/13R514 datë 05.05.2017 dhe CMR Nr. 1505/15 datë 10.05.2017
- Packing list
- Certifikatë Garancie me kohëzgjatje 24 muaj
- Polica e sigurimit datë 21.12.2016
- Deklarata doganore pa datë

- Fatura commerciale nr. 201705000037 datë 16.06.2017 me vlerë prej 30,293.67 euro dhe datë 16.06.2017 me vlerë prej 36,774.39 euro
- Certifikatë origjine nr. 0298936 datë 21.06.2017 dhe nr. 0639862 datë 21.06.2017
- CMR Nr. 39686 datë 20.06.2017
- Packing list
- Certifikatë Garancie me kohëzgjatje 24 muaj
- Polica e sigurimit datë 21.12.2016
- Deklarata doganore datë 01.07.2017

- Fatura commerciale nr. 201705000036 datë 16.06.2017 me vlerë prej 172,534.22 euro
- Certifikatë origjine nr. 0298938 datë 26.06.2017
- Dokument transporti ajror me nr. 22170115401
- Packing list
- Certifikate Garancie me kohëzgjatje 24 muaj
- Polica e sigurimit datë 21.12.2016
- Deklarata doganore pa datë me Nr.748

Pajisjet dhe mallrat e ardhura më sipër janë marrë në dorëzim dhe janë bërë hyrje me:
Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 331, datë 21.09.2017
Fletë hyrje nr. 30, datë 30.12.2018
Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 360, datë 27.09.2017
Fletë hyrje nr. 65, datë 17.10.2017
Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 800, datë 16.08.2017
Fletë hyrje nr. 84, datë 22.12.2017
Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 802, datë 16.08.2017
Fletë hyrje nr. 76, datë 12.12.2017
Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 809, datë 08.08.2017
Fletë hyrje nr. 82, datë 22.12.2017
Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 810, datë 16.08.2017
Fletë hyrje nr. 83, datë 22.12.2017
Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 838, datë 24.08.2017
Fletë hyrje nr. 77, datë 12.12.2017
Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 839, datë 21.08.2017

Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 75, datë 08.02.2017
 Fletë hyrje nr. 1, datë 08.02.2018
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 298, datë 07.09.2017
 Fletë hyrje nr. 20, datë 07.09.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 398, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. 34, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 393, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. 38, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 396, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. 41, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 397, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. 42, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 395, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. 43, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 400, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. 45, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 400, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. -, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 390, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. 35, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 470, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. 55, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 411, datë 06.10.2017
 Fletë hyrje nr. -, datë 06.10.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 411, datë 22.12.2017
 Fletë hyrje nr. 75, datë 22.12.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 596, datë 22.12.2017
 Fletë hyrje nr. 75, datë 22.12.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 397, datë 22.12.2017
 Fletë hyrje nr. 79, datë 22.12.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 308, datë 18.09.2017
 Fletë hyrje nr. 25, datë 18.09.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 839, datë 15.11.2017
 Fletë hyrje nr. 75, datë 15.11.2017
 Me shkresën nr. 60, datë 19.01.2019 “Dërgim dokumentacioni” Spitali Universitar i Traumës
 ka përcjell dokumentacionin e marrjes në dorëzim të pajisjeve.
 Certifikata e Pranimit të Përkohshëm nr. 102/5, datë 03.04.2019.

Me shkresën nr. 719/5, datë 18.05.2020 të MSHMS është autorizuar pagesa prej **71,329.52 euro** për kontraktorin *I. Spa* për Adendumin nr. 970/4, datë 07.03.2017, për pajisjet:

në euro			
Nr.	Pajisje	Sasia	Cmimi
1	Tundës + Aksesor	1	1,190
2	Manipoli Kirurgjikal	1	30,696.81
3	Manipoli kirurgjikal (me faturën 201705000030)	1	31,687.26
4	Centrifuge	1	7,754.7
	Totali		71,329.52

Burimi: MSHMS

Pajisjet janë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

-Fatura komerciale nr. 201705000030 datë 22.05.2017 me vlerë prej 84,980.35 euro (pjesë e faturës)

- Certifikatë origjinë nr. T/0931958
- CMR Nr. 39472 datë 23.05.2017
- Packing list
- Certifikatë Garancie me kohëzgjatje 24 muaj
- Polica e sigurimit datë 21.12.2016
- Deklarata doganore pa datë me numër referimi M112

Fatura nr. 201905000031 I., datë 25.10.2019 me vlerë 30,696.81 euro
 Deklarat doganore datë 03.12.2019, për pajisjen Neurosurgery Handpieces,
 Packing List,
 Dokument transport (CMR)

Fatura nr. 201905000036 I., datë 11.12.2019 me vlerë 8,945.45 euro
 Deklarat doganore datë 19.03.2020, për pajisjen Refrigerated centrifuge, bench, with usb dhe
 shaker, , Packing List
 Dokument transport (CMR)

Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 159, datë 24.03.2020
 Fletë hyrje nr. 4, datë 24.03.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 157, datë 24.03.2020
 Fletë hyrje nr. 3, datë 24.03.2017
 Procesverbal i pritjes, kontrollit dhe Administrimit të mallit nr. 158, datë 24.03.2020
 Fletë hyrje nr. 5, datë 24.03.2017
 Me shkresën nr. 702, datë 27.03.2020 “Dërgim dokumentacioni” Spitali Universitar i Traumës
 ka përcjell dokumentacionin e marrjes në dorëzim të pajisjeve.
 Certifikata e Pranimit të Përkohshëm nr. 719/3, datë 18.05.2020.

2.7 Mbi administrimin e veprave të dorëzuara, funksionimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve.

Në zbatim të pikës 7 të Programit të Auditimit nr. 134/1, datë 08/02/2024 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Inventari kontabël;
2. Inventari fizik;
3. Procesverbali i marrjes në dorëzim;
4. Gjendja në magazinë;
5. Gjendja në punë/ose jo e pajisjeve;
6. Kartelat e mirëmbajtjes.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Në SUT u ushtrua auditim me zgjedhje⁵, për pajisjet mjekësore të furnizuara nga kontraktorët e projektit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Shqiptare”:

1. Kontratë Nr. 1179/16 firmosur në datë 30.03.2016 për shumën EURO 2,313,621.95 me kontraktorin I. S. dhe Adendum Nr. 970/4 datë 07.03.2017 me vlerë 571,712.29 Euro. Kontraktori/kompania Italiane I. S. ka përfituar në total vlerën 2,885,334.1 euro.
2. Kontratë Nr. 1179/15 firmosur në datë 30.03.2016 për shumën EURO 557,371.00 me kontraktorin A.V. Srl & T. Srl dhe Adendum Nr. 970/1 datë 21.02.2017 me vlerë 250,350.50

⁵ *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur”.

Euro. Kontraktori/kompania Italiane “A.V. Srl & T. Srl” ka përfituar në total vlerën 804,196.05 euro.

3. Kontratë Nr. 1179/13 firmosur ne date 25.03.2016 për shumën EURO 636,750.00 me kontraktorin C. M. S. S.p.A dhe Adendum Nr. 970/2 datë 23.02.2017 me vlerë 124,350 Euro. Kontraktori/kompania Italiane “C. M. S. S.p.A” ka përfituar në total vlerën 761,100 euro.

4. Kontratë Nr. 1179/18 firmosur ne date 11.04.2016 për shumën EURO 455,230.00 me kontraktorin A. I. S.p.A dhe Adendum Nr. 970/3 datë 24.02.2017 me vlerë 90,640 Euro. Kontraktori/kompania Italiane “A. I. S.p.A dhe Adendum” ka përfituar në total vlerën 545,870 euro.

Për pajisje mjekësore të likuiduara për periudhën 2019-2020 u audituan 17 pajisje me vlerë 210,952 euro.

Nga auditimi u konstatua se administrimi i pajisjeve mjekësore të instaluar në SUT është konform Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij.

Në mënyrë të detajuar u audituan pajisjet si më poshtë vijon:

Nr.	Pajisja	Kontabilizuar	Person në ngarkim	SIMP/Kartelë	Gjurmë defektsh	Në gjendje pune
1	Aparat ECHO Mod Lab 40	po	po	jo	jo	po
2	C-Arm “Robin S9”	po	po	jo	jo	po
3	Gruppo inox per sala lavaggio	po	po	jo	jo	po
4	Makine anestezie me monitor per pendante/mobile	po	po	jo	jo	po
5	Spektrofotometr Modeli: UV-1800	po	jo	jo	jo	po
6	Mikroskop per laborator Modeli: Oxion	po	po	jo	jo	po
7	Sistem i plote video-endoskopie	po	po	jo	jo	po
8	Pompe irrigimi/aspirimi	po	po	jo	jo	po
9	Insuflator me CO2	po	po	jo	jo	po
10	Sistem gerryerje (shaver) artroskopik	po	po	jo	jo	po
11	Artroskop	po	po	jo	jo	po
12	Laparoskop	po	po	jo	jo	po
13	Cisto-ureterskop	po	po	jo	jo	po

1. Aparat ECHO Mod Lab 40

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik.

Në kartel (në ngarkim) e ka E. N. me detyrë kryeinfermier në Shërbimin e Kirurgjisë Plastike. Pajisja ndodhet në pavionin e Kirurgjisë plastike.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore.

Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

2. C-Arm “Robin S9”

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik.

Në kartel (në ngarkim) e ka A. M. me detyrë kryeinfermiere në Bllokun Operator.

Pajisja ndodhet në bllokun operator qëndror.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore.

Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

3. Gruppo inox per sala lavaggio

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik.

Në kartel (në ngarkim) e ka F. B. me detyrë përgjegjës material në Bllokun Operator.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore.

Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

4. Makine anestezie me monitor per pendante/mobile

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik.

Në kartel (në ngarkim) e ka A. L. me detyrë kryeinfermiere në Sallën e Urgjencës. Pajisja është në bllokun operator urgjencë.

Pajisja është aktualisht në kontratë mirëmbajtje full risk. Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore.

Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

5. Spektrofotometrer Modeli: UV-1800

Në kartel (në ngarkim) e ka A. R. me detyrë magazinier në sektorin e shërbimeve të brendshme.

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin konabël të SUT) dhe në inventarin fizik.

Pajisja është në magazinë dhe nuk është më në përdorim. Është pajisje e kthyer nga laboratorin në magazinë, për arsye se laboratorin është dhënë me koncension.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore.

Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve.

6. Mikroskop per labrator Modeli: Oxion

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik.

Në kartel (në ngarkim) e ka A. R. me detyrë magazinier në sektorin e shërbimeve të brendshme.

Pajisja ndodhet në magazinë dhe për arsye se ka kaluar nga shërbimi anatomi patologjike në magazinë.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore. Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve.

7. Sistem i plote video-endoskopie

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik. Në kartel (në ngarkim) e ka A. M. me detyrë kryeinfermiere në Sallën e Urgjencës. Pajisja ndodhet në Bllokun Operator Qendror.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore. Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

8. Pompe irrigimi/aspirimi

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik. Në kartel (në ngarkim) e ka A. M. me detyrë kryeinfermiere në Sallën e Urgjencës. Pajisja është në Bllokun Operator Qendror.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore. Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

9. Insuflator me CO2

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik. Në kartel (në ngarkim) e ka A. M. me detyrë kryeinfermiere në Sallën e Urgjencës. Pajisja ndodhet në Bllokun Operator Qendror.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore. Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

10. Sistem gerryerje (shaver) artroskopik

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik. Në kartel në (në ngarkim) e ka A. M. me detyrë kryeinfermiere në Sallën e Urgjencës. Pajisja ndodhet në Bllokun Operator Qendror.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore. Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

11. Artroskop

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik. Në kartel në (në ngarkim) e ka A. M. me detyrë kryeinfermiere në Sallën e Urgjencës. Pajisja ndodhet në Bllokun Operator Qendror.

Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore. Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

12. Laparoskop

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik. Në kartelë në (në ngarkim) e ka A. M. me detyrë kryeinfermiere në Sallën e Urgjencës. Pajisja ndodhet në Blllokun Operator Qendror. Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore. Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

13. Cisto-ureteroskop

Pajisja është e kontabilizuar (në inventarin kontabël të SUT) dhe në inventarin fizik. Në kartelë në (në ngarkim) e ka A. M. me detyrë kryeinfermiere në Sallën e Urgjencës. Pajisja ndodhet në Blllokun Operator Qendror. Nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Nuk është hapur kartelë shërbimi për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj). Pajisja ka qenë në garanci për një periudhë 24 mujore. Nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve. Aktualisht pajisja është në gjendje pune.

Nga 17 pajisjet e sipër cituara, vetëm dy pajisje janë me kontratë mirëmbajtje, kjo për arsye të mungesës së fondeve.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Për realizimin e projektit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes nuk kanë zbatuar përcaktimet e marrëveshjeve për fuqizimin e Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës, lidhur me institucionin kompetent për zhvillimin e procedurave të prokurimit, si dhe ato lidhur me përqindjen e kredisë së ndihmës që do të përdorej për kosto lokale dhe/ose në vendet në zhvillim, por kanë zbatuar ndryshimet e marrëveshjes qeveritare, ende pa hyrë në fuqi këto ndryshime.

Procedurat e prokurimit (1 procedurë me 7 lote) janë zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë e cila bazuar në ligjet në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave, nuk e kishte një kompetencë të tillë, si dhe në dokumentet që përcaktojnë kriteret dhe procedurën e prokurimit është përcaktuar një përqindje më e lartë e kredisë së ndihmës për kosto lokale dhe/ose në vendet e OECD-së, duke zbatuar, pa hyrë ende në fuqi, parashikimet e ndryshimeve të marrëveshjes qeveritare, të cilat janë ratifikuan nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 21.12.2015 dhe janë botuar në fletoren zyrtare nr. 246, datë 21.01.2016, ndërkohë që njoftimi për fillimin e procedurave të prokurimit është bërë në datën 29.07.2015 dhe shpallja e fituesve të këtyre procedurave është bërë më 26.11.2015 në kundërshtim me në nenet: 4 pika b, paragrafi i parë; 5, pika c, paragrafi 4,5; 6; 14; Aneksi 3, Seksioni I pika 1,3; Aneksi 3, Seksioni II pika 1,2,4 të Ligjit nr. 9617, datë 16.10.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me objekt realizimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-42 të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për të korigjuar këtë praktikë në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe në lidhje me ndryshimet e tyre, të bëhet konfirmim nga sektori përkatës i këshillimit ligjor lidhur me momentin e hyrjes në fuqi të dispozitave përkatëse që ju kalojnë ose ju heqin strukturave të tyre kompetencat juridike lidhur me zbatimin e projekteve, me qëllim shmangien e këtyre praktikave në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Në implementimin e projektit ka pasur vonesa të pajustificuara të cilat kanë ardhur kryesisht nga pala shqiptare, pasi rezulton se nga fillimi i tij deri në vitin 2014, për projektin nuk rezulton të jetë zhvilluar asnjë aktivitet për të vënë në lëvizje strukturat kompetente të cilat do të siguronin zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja. Ky projekt për një periudhë të gjatë nuk ka funksionuar duke rezultuar në gjendje jo aktive. Edhe pse një vonesë e tillë nuk ka pasur efekt financiar, ka ndikuar në mos arritjen në kohë të objektivit kryesor të tij, i cili është një i vetëm dhe qëndron në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të popullsisë shqiptare, në mënyrë të veçantë të popullsisë së prekur nga trauma, si dhe objektivave specifik.

Referuar shkresës nr. 1179/29, datë 23.11.2016, implementimi real i projektit ka filluar në vitin 2014, kur janë evidentuar nevojat fillestare të spitalit nga eksperti italian i Cooperazione Italiana, ndërsa realizimi i procedurave të prokurimit ka filluar në vitin 2015. Nga ky moment deri në përfundim të projektit kanë kaluar 5 vjet dhe rezultati i arritur nga projekti është i ndarë në përpjesëtim jo të drejtë në vite, pasi edhe gjatë fazës së zbatimit të kontratave me operatorët

ekonomik fitues, projekti nuk ka vazhduar për shkak të rikonstruksionit të Spitalit Universitar të Traumës. Ky fakt ka ndikuar ka ndikuar në një tjetër vonesë për realizimin e tij.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Spitalin Universitar të Traumës nuk është hartuar raporti përfundimtar i implementimit të projektit, në të cilin duhet të ishin analizuar realizimi i objektivave specifik dhe të përcaktoheshin me hollësi shkaqet, arsyet dhe argumentet për vonesën e realizimit të projektit duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-42 të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Njësia e Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me Spitalin Universitar të Traumës, të marrin masa për hartimin e një raporti përfundimtar të implementimit të projektit, ku të analizohet realizimi i objektivave specifik dhe të përcaktohen me hollësi shkaqet, arsyet dhe argumentet për vonesën e realizimit të projektit duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse.

Brenda datës 30.09.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nuk ka një ndarje të qartë në lidhje me shumat që janë akorduar për secilin nga komponentët e projektit dhe nuk është evidentuar ndarja e zërave sipas kontratave të lidhura, pasi në një prej kontratave të lidhura mund të jene përfshirë pajisje që u shërbejnë 2 ose më shumë loteve, të cilat në vetvete përfshinë pajisje që mund t'i përkasin komponentëve të ndryshëm.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-42 të Projekt Raportit të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Njësia e Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me spitalin e traumës të ngrejë një grup pune i cili të ndajë sipas komponentëve të projektit të gjitha pajisjet mjekësore në bazë të kontratave të lidhura, me qëllim evidentimin e saktë të tyre për të qartësuar përmbushjen e komponentëve dhe objektivave specifik të programit.

Brenda datës 30.09.2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për zbatimin e projektit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë nuk është ngritur komiteti drejtues, për pasojë asnjë nga detyrat të cilat citohen në nenin 6 të marrëveshjes së programit nuk rezulton të jetë kryer, konkretisht: nuk është kryer monitorimi dhe vlerësimi i programit në të gjitha fazat e tij. Po ashtu nuk është kryer analiza përfundimtare e kontrollit të veprimtarive të programit. Si rrjedhojë sistemi i monitorimit të programit nuk ka funksionuar.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-36 të Raportit të Auditimit)

4.1 Rekomandime: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të administrohen nga ana e saj në të ardhmen, t'i përmbahet marrëveshjeve bazë financiare si dhe programit të financimit, duke ngritur strukturat përkatëse të monitorimit të përcaktuara në marrëveshje, me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e projektit si dhe evidentimin e problemeve në faza të ndryshme të programit, rritjen e efektivitetit të projekteve me financime të huaja.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nuk ka dokumentimin të të gjitha fazave të implementimit të projektit, në ruajtjen e dokumentacionit, si dhe në ndjekjen dhe monitorimin e projektit nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për menaxhimin e tij, në përputhje me përcaktimin e sanksionuar në Marrëveshjen bazë, ku përcaktohet se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale duhet të kujdeset për koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe menaxhuese të nevojshme për realizimin e programit. Detyrat për menaxhimin e projektit nuk ka qenë e deleguar dhe e mirë përcaktuar nga ana e institucioneve shqiptare të përfshira në implementimin e tij. Ky projekt ka mangësi të theksuar si në dokumentacionin e fazave të zhvillimit ashtu edhe në mbledhjen, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve fizik dhe letrave të punës për periudhën nga fillimi i tij deri më datë 11.11.2014. Edhe gjatë fazës së implementimit të tij nga Ministria e Shëndetësisë kur janë caktuar drejtuesit e programit, nuk janë caktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të përfshirë në implementimin e projektit dhe dorëzimi i dokumentacionit nga njëri staf në tjetrin nuk është dokumentuar dhe zhvilluar sipas procedurave të kërkuara nga aktet ligjore në fuqi.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-36 të Raportit të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të administrohen nga ana e saj në të ardhmen, të përcaktojë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të përfshirë në implementimin e projekteve, në përputhje me marrëveshjet përkatëse, me qëllim monitorimin e projektit dhe nxjerrjen e përgjegjësive në rastet e vonesave të mundshme, si dhe dorëzimi i dokumentacionit në rastet e ndryshimit të stafit të dokumentohet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në përfundim të projekteve të merren masa për arkivimin e plotë të dokumentacionit të projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk është përcaktuar një afat për përfundimin e projektit, si dhe një grafik kohe për jetëgjatësinë dhe ecurinë në vite, nuk është hartuar një dokument i vlerësimit të projektit (PAD), veprime të cilat kanë sjellë një tejzgjatje në kohë për zbatimin të tij (projektit). Midis dy palëve Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe palës italiane, për ndalimin e projektit nuk është bërë një riaktivizim i projektit apo një program që cakton radhën e veprimeve në vazhdimësi, veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të Marrëveshjes së kredisë, ku përcaktohet se nëse zgjatja e pengesave është më e madhe se 24 muaj, palët janë të detyruara të bien dakord mbi vazhdimin e projektit dhe të caktojnë radhën e veprimeve. Nga situata dhe nga ecuria e projektit, vlerësojmë se koha e implementimit dhe rezultatet e prekshme, janë në raport jo të drejtë me njëri-tjetrin.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.3, faqe 36-42 të Raportit të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të administrohen nga ana e saj në të ardhmen, t'i përmbahet marrëveshjeve bazë financiare si dhe programit të financimit si dhe të përcaktohet një afat kohor për përfundimin e projektit, grafiku për ecurinë në vite, si dhe të hartohet dokumenti i vlerësimit të projektit. Në rastet e ndalimit të përkohshëm projektit të dakortësohet për vazhdimin e tij dhe të caktohet radha e veprimeve pas riaktivizimit të projektit.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcjell në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 1417/8 datë 09.08.2019, u konstatua se:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, për përgatitjen programe me afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për rekomandimet e lëna për projektin "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka raportuar pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimn e mëparshëm, pasi në shkresën 1417/8 datë 09.08.2019, prej subjektit është përcjellë vetëm plani i masave, veprime në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga KLSH janë dhënë 12 masa organizative nga të cilat 1 masë është zbatuar dhe 11 masa nuk janë zbatuar; nga 6 masa për shpërblim dëmi në vlerën 795,351.86 euro pa TVSH rezulton se nuk është zbatuar asnjë masë. Është rekomanduar 1 masë disiplinore e cila rezulton e pazbatuar. (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-30 të Raportit të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat nga ky auditim rezultuan të pazbatuara dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi.

Menjëherë e në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Kontratat e lidhura në kuadër të marrëveshjes në interpretim të Konventës së Vjenës të muajit maj 2009, Ligjit nr. 10 092, datë 09.03.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave”, si dhe doktrinës dhe jurisprudencës ndërkombëtare për shitjen e mallrave, kanë lënë shteg për keqinterpretime në zbatimin e tyre dhe në veçanti për eliminimin e tatimit të dyfishtë.

Për realizimin e plotë të projektit, në zbatim të kontratave respektive kontraktorët/kompanitë Italiane kanë përfituar në total vlerën 4,996,500.36 euro. Për këtë vlerë nuk është vlerësuar/marrë në konsideratë mbajtja tatimit mbi të ardhurat në vlerën 749,475.054 euro (4,996,500.36 x 15 %).

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale dhe kontraktorët/kompanitë Italiane nuk kanë aplikuar dhe dorëzuar në organet tatimore formularët për eliminimin e tatimit të dyfishtë në zbatim të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 42-59 të Raportit të Auditimit)

Rekomandimi 8.1: Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, t’i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për interpretim lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, date 10.02. 2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit te dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”, për të dhënë argument shterues lidhur me mbajtjen ose jo të tatimit mbi të ardhurat, për të shmangur keq interpretimet e zbatimit të dispozitave të sipërcituara në lidhje me këtë çështje.

Në vijimësi

Rekomandimi 8.2: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në vlerësimin dhe mbajtjen e tatimit mbi të ardhurat, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektimi i 17 pajisjeve mjekësore të furnizuara dhe instaluar në SUT me vlerë 210,952 euro për periudhën 2019-2020 u konstatua se megjithëse pajisjet janë

në gjendje pune nuk ka gjurmë auditimi/dokumentare, për defektet (nëse ka pasur) brenda periudhës së garancisë dhe kryerjen e riparimeve.

- Nga SUT nuk është mbajtur Sistemi i Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM)/kartela për shërbimet e kryera për pajisjet si dhe dokumentimin e historikut të saj (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj.).

Sa më sipër në plotësim të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet.

(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.7, faqe 58-61 të Raportit të Auditimit)

Rekomandimi 9.1: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Spitali Universitar i Traumës të marrin masa në planifikimin në buxhet të fondeve për sigurimin e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore duke rritur jetëgjatësinë e tyre.

Menjëherë

Rekomandimi 9.2: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ti kërkoj Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa për regjistrimin në Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM)/hapin kartelat e shërbimit për dokumentimin e historikut të pajisjes (defektet, riparimet, zëvendësimi i pjesëve të këmbimit etj.).

Menjëherë

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT